



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISTINA
FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT – CIVIL ENGINEERING FACULTY
Rr. Agim Ramadani, Ndërtesa e "Fakulteteve Teknike", 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 554 899 URL: <https://fin.uni-pr.edu> e-mail: fin@uni-pr.edu

Ref. nr. 1613/2

Prishtinë 16.06.2020

Formulari F3

**RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMËS
MASTER**

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT				
Vendimi i Këshillit të FIN-it	Nr.	223/I	Date	26.01.2024
Komisioni vlerësues sipas vendimit të këshillit	1.	Prof.Asoc.Dr. Misin Misini		Kryetar
	2.	Prof.Asoc.Dr. Arton Dautaj		Mentor
	3.	Prof..Asst. Dr. Zijadin Guri		Anëtar
Emri i projekt propozimit i miratuar sipas vendimit të këshillit të FIN.	PROJEKTIMI SIZMIK I STRUKTURAVE METALIKE			
Vlerësimi i dorëshkrimit				
Vlerësim i dorëshkrimit: "PROJEKTIMI SIZMIK I STRUKTURAVE METALIKE" të kandidatit Alban Sertolli, Bachelor e ndërtimtarisë–drejtimi Konstruktiv. Bazuar në detyrën e parashtruar në raportin e projekt propozimit dhe punën e realizuar nga kandidati paraqesim këtë: R A P O R T Punimi Master, me titull: "PROJEKTIMI SIZMIK I STRUKTURAVE METALIKE", i përgatitur nga Alban Sertolli, Bachelor i ndërtimtarisë, përmban gjithsej 103 faqe të shkruara, ku përfshihen edhe figurat, tabelat dhe diagramet. Në fund të punimit prezantohet literatura e përdorur, ku janë të përfshira 21 burime të ndryshme.				



I. Analiza e punimit

Në paraqitjen e tij tërësore punimi është i ndarë në tetë kapituj. Kapitulli i parë i punimit i kushtohet prezantimit të përgjithshëm të bazave të projektimit sipas Eurokodeve, me theks të veçantë në parimet themelore të sigurisë, besueshmërisë, gjendjeve kufitare dhe karakteristikave të materialeve e prerjeve sipas Eurokodit 3.

Kapitulli i dytë i punimit i është kushtuar projektimi dhe analiza sizmike sipas Eurokodit 8. Në këtë kapitull janë paraqitur kërkesat themelore për projektimin sizmik, kriteret e performancës dhe mënyra e kombinimit të veprimit sizmik me veprimet tjera. Po ashtu janë analizuar karakteristikat që duhet të ketë struktura për rezistencë ndaj tërmetit, si rregullsia në plan dhe në lartësi, ndikimi i parregullsive në analizën sizmike, si dhe metodat kryesore të analizës sizmike. Përveç kësaj, kapitulli përfshin edhe çështje të rëndësishme si përdredhja aksidentale, kombinimi i komponentëve të veprimit sizmik, llogaritja e zhvendosjeve dhe efektet e rendit të dytë në analizën lineare elastike.

Në kapitullin e tretë janë trajtuar kontrollet kryesore të projektimit, si: kushti i rezistencës, duktiliteti, ekuilibri, rezistenca e diafragmave dhe themeleve, si dhe kontrolli i fugave sizmike.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISTINA
FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT – CIVIL ENGINEERING FACULTY
Rr. Agim Ramadani, Ndërtesa e "Fakulteteve Teknike", 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 554 899 URL: <https://fin.uni-pr.edu> e-mail: fin@uni-pr.edu

Ref. nr. _____

Prishtinë ____/____/____

Gjithashtu është shqyrtuar kufizimi i dëmtimeve dhe drifteve të kateve, për të siguruar që struktura i plotëson kriteret e sigurisë dhe përdorueshmërisë.

Në kapitullin e katërt trajtohet projektimi i strukturave të çelikut, duke përfshirë objektivat kryesore të projektimit, tipologjitë dhe llojet e strukturave. Gjithashtu shqyrtohen faktorët e sjelljes, të cilët ndikojnë në mënyrën se si struktura reagon ndaj ngarkesave dhe veprimeve sizmike.

Në kapitullin e pestë paraqitet përshkrimi i përgjithshëm i objektit dhe i sistemit konstruktiv, duke përfshirë materialet, veprimet dhe ngarkesat që ndikojnë në strukturë. Vëmendje e veçantë i kushtohet çelikut konstruktiv, ngarkesave të përhershme, të përkohshme dhe veprimeve sizmike si dhe kërkesave të projektimit sipas Eurokodit 8. Në shembullin e shqyrtuar paraqiten hapat kryesorë të projektimit sipas EN 1998-1 për një objekt shumëkatësh me sistem strukturor Moment Resisting Frames – MRF. Modelimi dhe analiza strukturore është realizuar me softuerin MIDAS Gen, ku janë marrë parasysh veprimet sizmike dhe sjellja jolineare e elementeve mbajtëse. Në kuadër të analizës është shqyrtuar formimi i nyjeve plastike në elementet strukturore, me qëllim vlerësimin e kapacitetit dhe sjelljes së objektit nën veprime sizmike. Për vlerësimin më të plotë të



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISTINA
FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT – CIVIL ENGINEERING FACULTY
Rr. Agim Ramadani, Ndërtesa e “Fakulteteve Teknike”, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 554 899 URL: <https://fin.uni-pr.edu> e-mail: fin@uni-pr.edu

Ref. nr. _____

Prishtinë ____/____/____

performancës strukture është realizuar edhe analiza jolineare statike. Kjo analizë mundëson vlerësimin hap pas hapi të reagimit të strukturës, identifikimin e zonave kritike, shpërndarjen e nyjeve plastike dhe përcaktimin e nivelit të sigurisë së objektit ndaj veprimeve sizmike.

Procesi i modelimit të strukturës dhe analizat përkatëse janë dhënë në kapitullin e gjashtë. Këtu përshkruhet modeli matematikor i përdorur për llogaritje, metodat e analizës dhe mënyra e përcaktimit të sjelljes së strukturës nën veprimin e ngarkesave. Vëmendje e veçantë i kushtohet analizës modale dhe spektrit të reagimit, të cilat përdoren për vlerësimin e ndikimeve sizmike në strukturë. Gjithashtu, në këtë kapitull analizohen format kryesore të lëkundjeve, imperfeksionet në analizën globale të ramave, si dhe stabiliteti i strukturës ndaj efekteve të rendit të dytë, përkatësisht efekteve $P-\Delta$. Më tej trajtohet projektimi dhe analiza e elementeve kryesore të strukturës, duke përfshirë lidhjet, trarët, shtyllat, lidhjen tra-shtyllë dhe lidhjen shtyllë-themel. Në fund, shqyrtohet kufizimi i dëmtimeve dhe analiza Pushover, me qëllim të vlerësimit më të plotë të sjelljes së strukturës gjatë veprimeve sizmike.

Rekomandimet kryesore që dalin nga analiza dhe projektimi i strukturës janë dhënë në kapitullin e shtatë. Këto rekomandime



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, Ndërtesa e “Fakulteteve Teknike”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 38 554 899

URL: <https://fin.uni-pr.edu>

e-mail: fin@uni-pr.edu

Ref. nr. _____

Prishtinë ____/____/____

lidhen me mënyrën e projektimit, përzgjedhjen e materialeve, dimensionimin e elementeve, realizimin e lidhjeve konstruktive dhe respektimin e kërkesave sipas standardeve përkatëse.

Mbi bazën e formulimeve të dhëna, në kapitullin e tetë, bëhet përmbledhja e rezultateve të arritura nga projektimi dhe analiza e strukturës. Theksohet se përmes kontrolleve të realizuara është vlerësuar sjellja e strukturës, rezistenca e elementeve, stabiliteti dhe përmbushja e kriterëve të sigurisë. Ky kapitull përmbyll punimin duke treguar rëndësinë e projektimit dhe sjelljen sizmike të elementet e përkatëse.

II. Vlerësimi dhe Propozimi i Komisionit

Vlerësimi:

Në bazë të analizës së punimit master, Komisioni vlerëson se kandidati me sukses shtjellon problematikën e Sjelljes sizmike të strukturave metlike.

Komisioni konsideron se kandidati ka treguar njohuri solide në problematikën që ai në këtë punim e prezanton. Edhe nga aspekti teknik ky punim, me shumë figura, tabela dhe diagrame, është në nivel të konsiderueshëm.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

"HASAN PRISHTINA"

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, Ndërtesa e "Fakulteteve Teknike", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 38 554 899

URL: <https://fin.uni-pr.edu>

e-mail: fin@uni-pr.edu

Ref. nr. _____

Prishtinë ____/____/____

Komisioni vlerëson se materiali i shkruar i referohet në mënyrë të plotë dhe korrekte të gjitha referencave të literaturës së vendosur në fund të punimit.

Propozim:

Komisioni për vlerësimin e punimit master me titull: "PROJEKTIMI SIZMIK I STRUKTURAVE METALIKE", të kandidatit Alban Sertolli, Bachelor i ndërtimtarisë, konstaton se punimi i dorëzuar i plotëson kushtet të cilat kërkohen me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Rregulloren për Studime Master të FIN, prandaj edhe i propozon Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në Prishtinë që këtë raport ta aprovoi dhe të vazhdoi procedurën për mbrojtjen publike të tij.

Prishtinë, 12.06.2026

Komisioni:

Prof. Asoc.Dr. Misin Misini, kryetar

Prof. Asoc.Dr. Arton Dautaj, mentor

Prof. Asst.Dr. Zijadin Guri, anëtar

Pranuar më 10.06.2026			
Nj. orig.	Numer	Shtojca	Vlera
06	1726/1	-	-

Abstract

The seismic design of steel structures using different systems has a crucial role ensuring stability from seismic loads. This thesis focuses on the design of structure according to Eurocode 8 using Moment Resisting Frame (MRF) also other associated Eurocodes. The study presents the theoretical of load actions, structural modeling, adopted system, ductility class and behavior factor.

A practical case study we have developed a multi-storey with MRF system. Combination of gravitational and seismic loads were applied to the structure, according to which the resistance of the structural elements were checked. Through the implementation of Eurocode rule, it is ensured that the structure is able to withstand seismic loads, avoiding collapse, limiting damage and maintaining the integrity of the structure.

Structural modeling and analysis was performed using MIDAS Gen software, which took gravitational and seismic loads and the formation of plastic hinges in the supporting elements. The structural behavior was also evaluated using nonlinear static analysis (pushover analysis).

From the analysis, we see that seismic actions are often decisive for the design of load-bearing elements such as beams, columns and joints. The selection of the system (MRF, CBF, EBF) affects the stiffness, ductility and design requirements.

As a practical case study illustrate a multi-storey steel building with MRF system using Eurocode rules, ensure stable behavior fulfilling criteria of safety and structural performance in seismic hazard areas.

Keywords: *Seismic Design, Eurocode 8, Moment-Resisting Frames (MRF), Midas Gen*

Pranuar me: 10.06.2016			
Nj. org.	Numer	Shtojca	Vlera
06	1576/1	-	-

Abstrakti

Projektimi sizmik i strukturave duke përdorur sisteme të ndryshme ka ndikim thelbësor për të siguruar stabilitet ndaj veprimeve sizmike. Tema trajton projektimin e një strukture sipas Eurokodit 8 duke përdorur Ramat Moment Rezistuese (MRF) si dhe Eurokodet tjera që lidhen me konstruksionet metalike. Në këtë studim trajtohet pjesa teorike e veprimit të ngarkesave, modelimi i strukturës, përzgjedhja e sistemit, klasës së duktilitetit dhe faktorit të sjelljes.

Si rast studimi është përvetësuar struktura metalike disa katëshe sipas sistemit MRF. Në strukturë janë aplikuar kombinimet e ngarkesave gravitacionale dhe sizmike sipas të cilave është bërë kontrolli e rezistencës për elementet e strukturës. Përmes zbatimit të rregullave të Eurokodeve, sigurohet që struktura t'i përballojë ngarkesat sizmike duke evituar kolapsin, kufizuar dëmet si dhe të ruaj integritetin e strukturës.

Modelimi strukturor dhe analiza është realizuar nga softueri MIDAS Gen, në të cilin janë marrë parasysh ngarkesat gravitacionale, sizmike dhe formimi i nyjeve plastike në elementet mbajtës. Hap pas hap është vlerësuar edhe sjellja strukturore e realizuar përmes analizës jolineare statike (pushover analysis).

Nga analiza vërejmë që veprimet sizmike shpesh janë përcaktuese për dimensionimin e elementeve mbajtëse siç janë trarët, shtyllat dhe nyjet. Përzgjedhja e sistemit (MRF, CBF, EBF) ndikon në ngurtësinë, duktilitetin dhe kërkesën e projektimit.

Nga punimi shohim që një strukturë çeliku me sistem MRF e mbështetur nga rregullat e Eurokodit, ofron sjellje të qëndrueshme duke përmbushur kriterin e sigurisë dhe performancës strukturore në zonat me rrezik sizmik.

Fjalët kyçe: *Analiza sizmike, Eurokodi 8, Rami Moment Rezistues (MRF), Midas Gen*

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT
DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV



PROJEKTIMI SIZMIK I STRUKTURAVE METALIKE
PUNIM DIPLOME

Mentori:

Prof.Dr. Misin Misini

Studenti:

BSc.Alban Sertolli

Qershor 2026

FALENDERIME

Me rastin e përfundimit të këtij punimi, shpreh mirënjohjen dhe falenderimin për profesorët, Prof. Dr. Misin Misini dhe Prof. Dr. Arton Dautaj për të gjitha sygjerimet që punimi të marrë këtë formë dhe përmbajtje.

Për njohuritë e fituara gjatë studimeve, falenderoj të gjithë ata profesorë që kanë pasur durimin dhe nuk hezituan të na mbështesin gjatës kësaj kohe në zgjerimin e njohurive për fushën e inxhinirisë së ndërtimit.

U falenderohem të gjithë atyre që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë më kanë mbështetur përgjatë këtyre viteve.

Padyshim mbështetja ime më e madhe ka qenë familja. Andaj, i falenderoj për inkurajimin e pandërprerë, i cili bëri që sfidat gjatë kësaj kohe të jenë më të lehta.

Përmbajtja

Lista e figurave	v
Lista e tabelave	vi
Abstrakti.....	viii
1. Hyrje	1
1.1 Përshkrim i përgjithshëm	1
1.2 Standardet Eurokod.....	1
1.2.1 Përfitimet nga Eurokodet	2
1.2.2 Hartimi i Eurokodeve	2
1.2.3 Eurokodi 3.....	2
1.3 Bazat e projektimit.....	3
1.3.1 Konceptet bazike.....	3
1.3.2 Menaxhimi i besueshmërisë.....	3
1.3.3 Variablat bazë	4
1.3.4 Gjendja e fundit kufitare (ultimate limit state).....	4
1.3.5 Gjendja kufitare e shfrytëzimit	5
1.3.6 Jetëgjatësia	5
1.3.7 Qëndrueshmëria	6
1.4 Materiali.....	6
1.4.1 Specifikat e materialit	6
1.4.2 Karakteristikat mekanike	7
1.4.3 Qëndrueshmëria sipas karakteristikave të trashësisë	8
1.4.4 Rezistenca ndaj lodhjes.....	8
1.4.5 Rezistenca nga korrozioni	8
1.5 Karakteristikat gjeometrike dhe tolerancat.....	8
1.5.1 Klasifikimi i prerjeve tërthore sipas EC 3 (Eurokodi 3).....	9
1.5.2 Klasifikimi i prerjeve tërthore që janë nën veprimin e përdredhjes.....	10
2. Eurokodi 8	11
2.1 Eurokodi EN 1998-1	11
2.2 Kërkesat e performancës dhe kriteret e konfirmimit.....	12
2.2.1 Kërkesat themelore	12
2.2.2 Kombinimet e veprimit sismik me veprimet tjera	12

2.3	Karakteristikat e strukturës për rezistencë ndaj tërmetit	13
2.3.1	Parimet bazë të projektimit konceptual	13
2.3.2	Elementet parësor dhe sekondarë sizmik	14
2.4	Kriteri i strukturës për rregullësi	14
2.4.1	Kritere për rregullsinë në plan	15
2.4.2	Kriteri për rregullësi në lartësi	16
2.4.2.1	Pasojat e rregullsisë strukturë në analizën sizmike	16
2.5	Metodat për analiza sizmike	17
2.5.1	Metoda e analizës sipas forcave anësore	17
2.5.2	Shpërndarja e forcave sizmike horizontale	18
2.5.3	Analiza modale sipas spektrit të reagimit	19
2.5.4	Analiza statike jolineare (pushover)	19
2.5.5	Analiza jolineare në fushën kohore ("time-history analysis")	20
2.6	Përdredhja aksidentale	20
2.6.1	Ekscentriciteti aksidental	20
2.6.2	Efekti i përdredhjes aksidentale me analizën e forcave anësore	20
2.6.3	Përdredhja aksidentale me analizën e spektrit të reagimit	21
2.7	Kombinimi i efekteve të komponenteve të veprimit sizmik	22
2.8	Llogaritja e zhvendosjeve	22
2.9	Efektet e rendit të dytë në analizën sizmike linear elastike	23
3.	Kontrolla e projektimit	23
3.1	Kushti i rezistencës	24
3.2	Kushti i duktilitetit global dhe lokal	24
3.3	Kushti i ekuilibrit	25
3.4	Rezistenca e diafragmave horizontale	25
3.5	Rezistenca e themeleve	25
3.6	Kushti i fugave sizmike	26
3.7	Kufizimi i dëmtimeve	26
3.7.1	Kufizimi i drifteve të kateve	27
4.	Projektimi i strukturave të çelikut	28
4.1	Objektivat e projektimit të strukturave	28
4.2	Tipologjitë e strukturave dhe faktorët e sjelljes	29
4.2.1	Tipet e strukturave	29

4.3 Faktori i sjelljes.....	32
5. Përshkrimi dhe projektimi i strukturës.....	34
5.1 Përshkrimi i objektit.....	34
5.2 Materiali.....	39
5.2.3 Karakteristikat e çelikut	39
5.3 Veprimet e ngarkesave.....	39
5.3.1 Vlerat karakteristike të ngarkesave	39
5.3.2 Veprimet sizmike	40
5.3.3 Kombinimi i ngarkesave për rastin sizmik.....	48
5.3.4 Masat- kërkesat sipas EC8	48
6. Analiza e strukturës dhe llogaritja e modelit.....	50
6.1 Modelimi.....	51
6.2 Modeli matematikor dhe metoda e analizës.....	51
6.3 Metodat e analizës.....	52
6.3.1 Analiza e modale e spektrit të reagimit	52
6.6.3.1.1 Përdredhja aksidentale	52
6.4 Forma e lëkundjeve kryesore.....	56
6.5 Imperfeksionet për analiza globale të ramave	62
6.6 Stabiliteti i ramave nga efektet e rendit të dytë (efektet P-Δ)	63
6.7 Projektimi dhe analiza e elementeve të strukturës.....	69
6.7.1 Ekzekutimi i lidhjeve	71
6.7.2 Rregullat për trarët (EN 1998-1, p.6.6.2)	75
6.7.3 Rregullat për shtylla (EN 1998-1, p.6.6.3)	80
6.7.4 Rregullat për lidhjen tra-shtyllë (EN 1998-1, p.6.6.5)	81
6.7.5 Rregullat për lidhjet shtyllë-themel	83
6.8 Kufizimi i dëmtimeve	87
6.9 Analiza Pushover	90
6.9.1 Premisat e modelimit.....	90
7. Rekomandimet.....	101
8. Përfundimet	102
9. Referencat.....	103

Lista e figurave

Figura 1 Realizimi i detajeve kundër korrozionit	6
Figura 2 Diagrami sforcim-deformim (çelik me sjellje duktile)	7
Figura 3 Profilet e punuar nga prodhimi në të nxehtë.....	9
Figura 4 Profilet e formuara në të ftohtë.....	9
Figura 5 Sjellja e prerjes tërthore ndaj momenteve	10
Figura 6 Pasojat e rregullsisë në plan: a) strukturë e rregullt, b) strukturë e pa rregullt	17
Figura 7 Efektet e rrotullimit të simuluar nga faktori δ	21
Figura 8 Jashtëqendërsia aksidentale nga momentet përdredhëse të aplikuara në qendrën e masës të çdo kati	22
Figura 9 Skema e raportit ndërmjet veprimeve dhe rezistencës në strukturë.....	28
Figura 10 Ramat moment-rezistuese.....	29
Figura 11 Rama me kontraventime diagonale koncentrike (zonës disipuese vetëm në diagonalet e tërhequra)	30
Figura 12 Ramat me kontraventime ekscentrike.....	30
Figura 13 Lavjerrësi i përmbysur: a) zona disipuese në bazë të shtyllës, b) zona disipuese në shtylla ($N_{ed} < N_{pl,Rd} < 0.3$).....	30
Figura 14 Struktura me mure betoni dhe konstruksion metalik.....	31
Figura 15 Ramat e dyfishtë	31
Figura 16 Rama moment-rezistuese e kombinuar me mbushje	31
Figura 17 Dukja e objektit	35
Figura 18 Elementet e strukturës në katin karakteristik.....	36
Figura 19 Prerja tërthore e ramave moment rezistues drejtimi X.....	37
Figura 20 Prerja tërthore e ramave moment rezistues drejtimi Y	38
Figura 21 Spektri i reagimit sizmik horizontal	41
Figura 22 Grafiku i spektrit horizontal të projektimit.....	41
Figura 23 Spektrat elastik horizontal dhe spektri i projektuar	42
Figura 24 Dukja e modelit 3D.....	51
Figura 25 Forma e parë e lëkundjeve në drejtimin X (dukja në prerje).....	57
Figura 26 Forma e parë e lëkundjeve në drejtimin X $T_1=1.403s$ (dukja 3D).....	57
Figura 27 Forma e dytë e lëkundjeve në drejtimin Y (dukja në prerje).....	58
Figura 28 Forma e dytë e lëkundjeve në drejtimin Y $T_2=1.2037s$ (dukja 3D).....	58
Figura 29 Forma e tretë e lëkundjeve në drejtimin Z (dukja në bazë)	59
Figura 30 Forma e tretë e lëkundjeve në drejtimin Z $T_3=0.9095s$ (dukja 3D).....	59
Figura 31 Diagrami i momenteve përkulëse nga ngarkesat gravitacionale në drejtimin X dhe Y.....	60
Figura 32 Diagrami i forcave aksiale nga ngarkesat gravitacionale në drejtimin X dhe Y	60
Figura 33 Diagrami i forcave transversale nga ngarkesat gravitacionale në drejtimin X dhe Y	60
Figura 34 Diagrami i forcave aksiale nga ngarkesat sizmike në drejtimin X dhe Y.....	61
Figura 35 Diagrami i forcave transversale nga ngarkesat sizmike në drejtimin X dhe Y	61
Figura 36 Diagrami i momenteve përkulëse nga ngarkesat sizmike në drejtimin X dhe Y	61
Figura 37 Imperfeksioni global Figura 38 Imperfeksioni lokal	62
Figura 39 Shembull i ngarkesave ekuivalente horizontale (logaritja e forcave anësore për imperfeksionin global)	63
Figura 40 Efekti P- δ dhe Efekti P- Δ në një shtyllë të inkastruar	63

Figura 41 P-Δ në shtyllë dhe P-Δ në strukturë.....	64
Figura 42 Përcaktimi i parametrave për koeficientin e stabilitetit për efektin P-Δ	66
Figura 43 Paraqitja skematike e fazave dhe hapave për procesin e projektimit të elementeve të strukturës	69
Figura 44 Lidhja IPE330 në IPE500	71
Figura 45 Forcat e projektuara prerëse për tra MRF: kombinimi i ngarkesave gravitacionale me momente përkulëse plastike në skajet e trarit.....	76
Figura 46 Lidhja e trarit IPE 750x196 në HEM 700.....	79
Figura 47 Mënyra e lidhjes trarit në shtyllë: a) çernirë, b) gjysmë rigjide, c) rigjide	81
Figura 48 Forcat prerëse që veprojnë në panelin e brinjës së shtyllës	82
Figura 49 Baza e shtyllës e futur trarin e themelit (e marrë nga Cochran, 2003)	84
Figura 50 Shtylla rigjide e e lidhur në tra për MRF	84
Figura 51 Shembull i elementëve të bazës rigjide për MRF me pllaka të vendosura mbi themel	85
Figura 52 Shembulli i bazës së çernierës për elementet MRF	86
Figura 53 Forma e zhvendosjeve në drejtimin X	88
Figura 54 Forma e zhvendosjeve në drejtimin Y	88
Figura 55 Pozita dhe lloji i nyjeve plastike	91
Figura 56 Raporti i përgjithshëm forcë-deformim i nyjeve plastike dhe kriteret përkatëse të pranimiit	91
Figura 57 Objektivat e performancës në mënyrë grafike	93
Figura 58 Pushover Global Control- hapi 1	94
Figura 59 Pushover Load Case- hapi 2	95
Figura 60 Pushover Hinge Properties-hapi 3a (definimi i nyjeve për shtyllë).....	96
Figura 61 Pushover Hinge Properties-hapi 3b (definimi i nyjeve për shtyllë).....	96
Figura 62 Pushover Hinge Properties-hapi 3c (definimi i nyjeve për trarë)	97
Figura 63 Pushover Hinge Properties-hapi 3d (definimi i nyjeve për trarë)	97
Figura 64 Pushover Curve- Kurba nga Pushover.....	98
Figura 65 Shpërndarja e nyjeve plastike në të gjithë strukturën nga analiza Pushover- hapi 1	99
Figura 66 Shpërndarja e nyjeve plastike në të gjithë strukturën nga analiza Pushover- hapi 40	99
Figura 67 Formimi i çernierave plastike sipas MRF.....	100

Lista e tabelave

Tabela 1 Kufiri i sipërm i vlerave referente të faktorëve të sjelljes.....	32
Tabela 2 Klasa e çelikut	39
Tabela 3 Vlerat karakteristike të çelikut	39
Tabela 4 Vlerat nominale të sforcimit për prerjet e çelikut (EN1993-1-1, tabela 3.1)	39
Tabela 5 Vlerat e ngarkesave të përhershme dhe shfrytëzuese në kate	39
Tabela 6 Tipet e strukturave dhe vlerat e faktorit të sjelljes	44
Tabela 7 Vlerat e faktorit të sjelljes për strukturat e rregullta dhe të parregullta.....	44
Tabela 8 Parametrat e TIPIT 1 të spektrit të reagimit elastik (EN1998-1-1, tabela 3.2)	45
Tabela 9 Tipet e trallit.....	45
Tabela 10 Studimet gjeologjike të varura nga faktori i rëndësisë	46
Tabela 11 Klasa e rëndësisë për ndërtesa.....	46
Tabela 12 Kërkesa për klasën e rëndësisë sipas klasës së duktilitetit	47

Tabela 13 Vlerat e koeficientëve Ψ_{2i}, ϕ dhe Ψ_{Ei}	48
Tabela 14 Vlerat ϕ për llogaritjen e Ψ_{Ei}	48
Tabela 15 Vlerat e koeficientit Ψ	49
Tabela 16 Kërkesat për analizën e spektrit të reagimit sipas Eurokodit 8	52
Tabela 17 Jashtëqëndërsia aksidentale	52
Tabela 18 Kërkesat e analizës së forcave anësore nga Eurokodi 8	52
Tabela 19 Vlerësimi i metodës themelore T_1	53
Tabela 20 Hapat për caktimin e periodës themelore T_1	54
Tabela 21 Përmbledhja e hapave për analizën e situatës sizmike të projektimit	55
Tabela 22 Periodat dhe pjesëmarrja e masave për format e lëkundjeve	56
Tabela 23 Rezultatet për efektet P- Δ nga rasti i ngarkesës r_x	67
Tabela 24 Rezultatet për efektet P- Δ nga rasti i ngarkesës r_y	68
Tabela 25 Fazat e procesit të projektimit sizmik që kërkohen të dihen nga inxhinieri projektues	70
Tabela 26 Kontrollimi i kufizimit të dëmtimeve për MRF në drejtimin X	89
Tabela 27 Kontrollimi i kufizimit të dëmtimeve për MRF në drejtimin Y	89
Tabela 28 Tabela e niveleve të performancës i shprehur në terme të dëmtimeve në elemente strukturor ...	92
Tabela 29 Hapat që duhet ndjekur për definimin e analizës Pushover në Midas Gen	93

Abstrakti

Projektimi sizmik i strukturave duke përdorur sisteme të ndryshme ka ndikim thelbësor për të siguruar stabilitet ndaj veprimeve sizmike. Tema trajton projektimin e një strukture sipas Eurokodit 8 duke përdorur Ramat Moment Rezistuese (MRF) si dhe Eurokodet tjera që lidhen me konstruksionet metalike. Në këtë studim trajtohet pjesa teorike e veprimit të ngarkesave, modelimi i strukturës, përzgjedhja e sistemit, klasës së duktilitetit dhe faktorit të sjelljes.

Si rast studimi është përvetësuar struktura metalike disa katëshe sipas sistemit MRF. Në strukturë janë aplikuar kombinimet e ngarkesave gravitacionale dhe sizmike sipas të cilave është bërë kontrolli e rezistencës për elementet e strukturës. Përmes zbatimit të rregullave të Eurokodeve, sigurohet që struktura t'i përballojë ngarkesat sizmike duke evituar kolapsin, kufizuar dëmet si dhe të ruaj integritetin e strukturës.

Modelimi strukturor dhe analiza është realizuar nga softueri MIDAS Gen, në të cilin janë marrë parasysh ngarkesat gravitacionale, sizmike dhe formimi i nyjeve plastike në elementet mbajtës. Hap pas hap është vlerësuar edhe sjellja strukturore e realizuar përmes analizës jolineare statike (pushover analysis).

Nga analiza vërejmë që veprimet sizmike shpesh janë përcaktuese për dimensionimin e elementeve mbajtëse siç janë trarët, shtyllat dhe nyjet. Përzgjedhja e sistemit (MRF, CBF, EBF) ndikon në ngurtësinë, duktilitetin dhe kërkesën e projektimit.

Nga punimi shohim që një strukturë çeliku me sistem MRF e mbështetur nga rregullat e Eurokodit, ofron sjellje të qëndrueshme duke përmbushur kriterin e sigurisë dhe performancës strukturore në zonat me rrezik sizmik.

Fjalët kyçe: *Analiza sizmike, Eurokodi 8, Rami Moment Rezistues (MRF), Midas Gen*

Abstract

The seismic design of steel structures using different systems has a crucial role ensuring stability from seismic loads. This thesis focuses on the design of structure according to Eurocode 8 using Moment Resisting Frame (MRF) also other associated Eurocodes. The study presents the theoretical of load actions, structural modeling, adopted system, ductility class and behavior factor.

A practical case study we have developed a multi-storey with MRF system. Combination of gravitational and seismic loads were applied to the structure, according to which the resistance of the structural elements were checked. Through the implementation of Eurocode rule, it is ensured that the structure is able to withstand seismic loads, avoiding collapse, limiting damage and maintaining the integrity of the structure.

Structural modeling and analysis was performed using MIDAS Gen software, which took gravitational and seismic loads and the formation of plastic hinges in the supporting elements. The structural behavior was also evaluated using nonlinear static analysis (pushover analysis).

From the analysis, we see that seismic actions are often decisive for the design of load-bearing elements such as beams, columns and joints. The selection of the system (MRF, CBF, EBF) affects the stiffness, ductility and design requirements.

As a practical case study illustrate a multi-storey steel building with MRF system using Eurocode rules, ensure stable behavior fulfilling criteria of safety and structural performance in seismic hazard areas.

Keywords: *Seismic Design, Eurocode 8, Moment-Resisting Frames (MRF), Midas Gen*

1. Hyrje

1.1 Përshkrim i përgjithshëm

Konstruksionet metalike kombinojnë veçori unike që na japin zgjidhje ideale për shumë aplikime në industrinë e ndërtimit. Çeliku ofron shpejtësi në ndërtim, prodhim jasht fabrike që redukton rreziqet financiare të ndërlidhura me vonesat në vendndërtim. Vetitë e çelikut na mundësojnë liri më të madhe gjatë fazës së projektimit, që ndikon të kemi fleksibilitet dhe kualitet më të madh. Riciklimi dhe ripërdorimi i tij është faktor që kontribuon reduktimet e ndikimve në mjedis nga sektori i ndërtimit.¹

Tema do të trajtojë një strukturë metalike sipas rregullave të Eurokodit 3 (një pjesë të tyre) si dhe Eurokodit 8.

1.2 Standardet Eurokod

Eurokodet janë të përbëra nga 10 kode të cilat shërbejnë për projektimin e objekteve dhe strukturave inxhinierike nga betoni, çeliku, druri, strukturave muraturë dhe materialeve tjera. Fillimisht Eurokodet janë publikuar si standarde preliminare të njohura si ENV (*Norme Vornorme Européenne*) që nga viti 1992. Pastaj, pas shumë viteve dhe pas shumë ndryshimeve në verzionet preliminare, ato janë përmbledhur në standarde Europiane të njohura si EN (*Norme Européenne*), së bashku me anekse të cilat i përmbajnë informata specifike për secilin shtet. Eurokodet janë:

EN1990 Eurocode: Basis of design (Bazat e projektimit)

EN1991 Eurocode 1: Actions on structures (Veprimet në struktura)

EN1992 Eurocode 2: Design of concrete structures (Projektimi i strukturave nga betoni)

EN1993 Eurocode 3: Design of steel structures (Projektimi i strukturave nga çeliku)

EN1994 Eurocode 4: Design of composite steel and concrete structures (Projektimi i strukturave kompozite çelik dhe beton)

EN1995 Eurocode 5: Design of timber structures (Projektimi i strukturave të drurit)

EN1996 Eurocode 6: Design of masonry structures (Projektimi i strukturave muraturë)

EN1997 Eurocode 7: Geotechnical design (Projektimi gjeomekanik)

EN1998 Eurocode 8: Design of structures for earthquake resistance (Projektimi nga tërmeti)

EN1999 Eurocode 9: Design of aluminium structures (Projektimi i strukturave nga alumini)

¹ Design of steel structures (Luis Simões da Silva, Rui Simões, Helena Gervásio)

1.2.1 Përfitimet nga Eurokodet

Hartimi i kodeve ndërkombëtare për projektim nuk është diçka e re. P.sh. drafti i parë i EC2 për struktura betoni ishte bazuar ne CEB (Comité Européen duBeton) *Model Code* i vitit 1978 e hartura nga disa ekspert dhe entuziastë nga vende të ndryshme europiane. Poashtu EC 3 është bazuar në *Recommendations for Design of Steel Structures* të publikuar nga ECCS (European Convention for Constructional Steelwork), e cila u hartua nga disa ekspertë nga vendet europiane dhe vendet përreth. Motivi kryesor për t'i punuar ato ishte përmirësimi i artit të projektimit. Ka shumë avantazhe rreth asaj që të ketë standarde projektimi që pranohen nga të gjitha shtetet. Arsyeja e parë dhe më e rëndësishme që të ketë standarde të tilla, është që të eliminohen barrierat ndërmjet shteteve. Kjo do tu mundësojë kontraktorëve dhe konsulentëve nga shtetet anëtare që të konkurrojnë për punë në gjithë Europën. Gjithashtu ndihmojnë në lehtësimin e marketingut për materialet e ndërtimit, softuerët në gjithë Europën. E gjithë kjo shpie në bashkimin dhe shkëmbimin e eskperiencape me çrast do të ndikojë në uljen e kostos së prodhimit. Poashtu standardet e tilla do tu mundësojnë inxhinierëve që të punojnë nëpër vende të ndryshme. Përfitimet më të mëdha nga Eurokodet janë që inxhinierëve europianë mund t'i praktikojnë kudo nëpër Europë.

1.2.2 Hartimi i Eurokodeve

Përgjithësisht secili Eurokod është përgatitur nga një ekip i vogël i ekspertëve nga shteti përkatës. Ekipet janë formuar nën direktivat e komisioni EC (EC Commission). Nga vitit 1989 përgjegjësinë kryesore për përgatitjen dhe publikimin e Eurokodeve e ka CEN (Comité Européen de Normalisation), Organizata Europiane e Standardeve.

1.2.3 Eurokodi 3²

Aplikohet për të projektuar strukturat nga çeliku. Përmbushet me parimet dhe kërkesat për siguri dhe shfrytëzimin e strukturës, bazat për projektimin dhe verifikimin e të cilave janë dhënë në EN 1990 (Basis of structural design).

Eurokodi 3 ka lidhje me:

EN 1990 "Basis of structural design" EN 1991 "Actions on structures"

² Eurocode 3: Design of steel structures- Part 1-1, faqe 9

ENs, ETAGs and ETAs për të gjitha produktet e kërkuar për struktura çeliku EN 1090 "Execution of Steel Structures - Technical requirements" (Ekzekutimi i strukturave metalike-kërkesat teknik)

EN 1992 to EN 1999 kur strukturat dhe elementet e çelikut i referohen asaj

Eurokodi 3 ndahet në disa pjesë:

EN 1993-1 Design of Steel Structures: General rules and rules for buildings. EN 1993-2 Design of Steel Structures: Steel bridges.

EN 1993-3 Design of Steel Structures: Towers, masts and chimneys.

EN 1993-4 Design of Steel Structures: Silos, tanks and pipelines.

EN 1993-5 Design of Steel Structures: Piling.

EN 1993-6 Design of Steel Structures: Crane supporting structures.

Ndërsa EN 1993-1 përfshinë këto pjesë:

EN 1993-1-1 Design of Steel Structures: General rules and rules for buildings.

EN 1993-1-2 Design of Steel Structures: Structural fire design.

EN 1993-1-3 Design of Steel Structures: ((AC₂) Cold-formed members and sheeting (AC₂)).

1.3 Bazat e projektimit

1.3.1 Konceptet bazike

Eurokodi 3 përdoret në lidhshmëri me EN 1990 (Basis of structural design), EN 1991 (Actions on Structures), EN 1998 (Normative rules for the design of earthquake resistant structures and EN 1997 (Geotechnical design).

1.3.2 Menaxhimi i besueshmërisë

Projektimi dhe ekzekutimi i strukturave nga çeliku bëhet duke u bazuar në kërkesat e një niveli të besueshmërisë. Ky nivel i besueshmërisë arrihet përmes menaxhimit të kualitetit në projektim dhe ekzekutim sipas EN 1990 dhe EN 1090. Këto nivele që kanë të bëjnë me rezistencën dhe shfrytëzueshmërinë e strukturës mund të arrihen duke kombinuar disa masa si:

- masa preventive dhe mbrojtëse (duke implementuar barriera mbrojtëse, masa kundër zjarrit, masa kundër korodimit)
- masa gjatë projektimit (vlera representative të veprimeve ose faktorëve parcial)
- masa për kualitetin e menaxhimit
- masa për ndihmuar reduktimin e gabimeve njerëzore në projektim dhe ekzekutim,
- masa të tjera referuar aspekteve bazike si stabiliteti, qëndrueshmëria, ndikimet e tokës dhe mjedisit, modelet mekanike të përdorura dhe detajimi i strukturës
- masa që qojnë në ekzekutim efficient sipas standardeve të ekzekutimit (EN 1090)
- masa që qojnë në inspektim dhe mirëmbajtje të duhur.

1.3.3 Variablat bazë

Variablat bazike të përfshira në gjendjen kufitare të projektimit të strukturës janë veprimet, karakteristikat e materialit dhe të dhënat gjeometrike të strukturës dhe elementeve si lidhjeve.

Kur përdoren metoda e faktorëve parcial, duhet verifikuar që për të gjitha situatat e projektimit gjendja kufitare nuk tejkalohet kur vlerat projektuese të veprimeve ose efektet e veprimeve dhe rezistuese përdoren në modelin e projektuar.

Veprimet në strukturë mund të klasifikohen sipas veprimit në kohëzgjatje: veprimet e përhershme (pesha vetjake, pajisjet e përhershme), veprimet e përkoshme (ngarkesa shfrytëzuese në kate, era, sizmika dhe bora), ngarkesat aksidentale (eksplozimet ose ngarkesat goditëse).

1.3.4 Gjendja e fundit kufitare (ultimate limit state)

Është gjendja gjatë së cilës vie deri te thyerja (shkatërrimi- collapse) ose deri te format tjera të humbjes së qëndrueshmërisë së konstruksionit (structural failure). Gjendja e fundit kufitare konsideron: stabilitetin e konstruksionit dhe sigurinë e njerëzve.

Në strukturat e çelikut, gjendja e fundit kufitare i referohet dështimeve të brendshme që përfshijnë rezistencën e prerjes tërthore, rezistencën e strukturës dhe elementeve të saj ndaj dukurive të jostabilitetit dhe rezistencës së lidhjeve.

Gjendja e fundit kufitare, shqyrtimi i së cilës mund të jetë i nevojshëm përfshinë:

-humbjen e ekuilibrit të konstruksionit (loss of equilibrium)

-humbja e aftësisë mbajtëse si shkak i deformimeve të mëdha, transformimi i konstruksionit ose ndonjë pjese të tij në mekanizëm.

-humbja e aftësisë mbajtëse si shkak i lodhjes (fatigue) ose veprimeve të tjera të varura nga koha

Përgjithësisht duhet plotësuar kushti:

$$E_d \leq R_d$$

E_d – vlera e projektuar e veprimeve të jashtme

R_d – vlera e projektuar rezistuese

1.3.5 Gjendja kufitare e shfrytëzimit

I përgjigjet kushteve mbi të cilat parimet e kërkesave (service requirements), për konstruksionet ose elementin e konstruksionit, më nuk janë të plotësuar. Kërkesat e përdorimit kanë të bëjnë me:

-funksionimin e strukturës ose elementeve të saj

-komoditetin e njërëzve

-pamjen (paraqitjen) e strukturës së ndërtuar

Në strukturat metalike gjendja kufitare e deformimit dhe lëkundjeve merret në konsiderim.

Verifikimi i gjendjes kufitare të shfrytëzimit duhet ta plotësojë kushtin:

$$E_d \leq C_d$$

E_d - vlera projektuese e veprimeve specifike sipas kriterit të GJKSH

C_d - vlera projektuese kufitare sipas kriterit të GJKSH

1.3.6 Jetëgjatësia

Nga EN 1990, 2.4 definon kërkesat për jetëgjatësinë e strukturës. Për konstruksionet metalike (kapitulli 4 EC 3-1-1) jetëgjatësia varet nga efektet e korrozionit, konsumimi dhe lodhja mekanike. Prandaj të gjitha pjesët e ndieshme duhet të jenë lehtë të qasshme për inspektim, funksionim dhe të mbrojtur.

Jetëgjatësia e strukturave metalike është e lidhur ngushtë me mbrojtjen e tyre nga korrozioni. Mbrojtja bëhet duke ngjyrosur dhe mveshur pjesët metalike si dhe duke projektuar elemente të cilat shmangin akumulimin e ujit dhe mbeturinave.




Figura 1 Realizimi i detajeve kundër korrozionit³

1.3.7 Qëndrueshmëria

Çeliku është një prej materialeve me rezistente në tokë. Njëkohësisht material i reciklueshëm. Mund të riciklohet disa herë pa humbur vetitë, ruan përbërjen dhe redukton mbetjet në mjedis gjë që minimizon një ndër problemet më të mëdha në sektorin e ndërtimit. Strukturat e çelikut janë të qëndrueshme. Projektimi i duhur, strukturën e çelikut e bënë të ketë jetëgjatësi. Kur kombinohet jetëgjatësia dhe adaptimi i sturkturës shmanget nevoja për demolim dhe rindërtim.

1.4 Materiali

1.4.1 Specifikat e materialit

Çeliku konstruktiv që përdoret në strukturat metalike formohet nga alizhet e hekurit me karbon dhe elementeve tjera si mangan, silic, fosfor, sulfur etj. Disa nga këto elemente janë papastërti ndërsa disa të tjera shtohen me qëllim të caktuar.

Çeliku i petëzuar në nxehtësi (hot-rolled steel) është lloji më i përhapur në strukturat metalike që përdoret në elementet strukturore dhe lidhje të tyre. Kur përdoret procesi i furrës së harkut elektrik dhe derdhjes së vazhdueshme, ky çelik përmban (0.06-0.1) % karbon. Kur përdoret precesi bazë i oksigjenit ky çelik ka (0.2-0.25) % karbon.

³ Desing of steel structures (Luis Simões da Silva, Rui Simões, Helena Gervásio), fq.7

Elementet e çelikut të formuar në të ftohtë (cold-formed) prodhohen duke formuar pllaka çeliku me trashësi të vogël, në të cilat paraprakisht është aplikuar një shtresë zinku.

Pjesët tjera si bulonat, dadot, nënshtresat prodhohen nga çeliqe me rezistencë të lartë.

1.4.2 Karakteristikat mekanike

Janë të lidhura me vetitë deformabile. Ndër vetitë kryesore të çelikut janë: soliditeti në tërheqje, zgjatja procentuale, kontraksioni i prerjes tërthore, fortësia e çelikut, lakimi, duktiliteti, rezistenca në goditje dhe lodhja e celikut.

Nga EC3-1-1, 3.2 karakteristikat mekanike dhe fizike të çelikut janë:

Moduli i elasticitetit $E = 210 \text{ GPa}$

Koeficienti i Puasionit $\nu = 0.3$

Koeficienti linear termik $\alpha = 12 \times 10^{-6} / ^\circ\text{C}$

Pesha vëllimore $\rho = 7850 \text{ kg/m}^3$




Figura 2 Diagrami sforcim-deformim (çelik me sjellje duktile)

R_m -soliditeti maksimal në tërheqje

R_{eH} -pika e kufirit të elasticitetit

R_{eL} -kufiri i rrëshqarshmërisë

A_{gt} -sforcimi maksimal

A -pika e këputjes

1.4.3 Qëndrueshmëria sipas karakteristikave të trashësisë

Qëndrueshëria (Toughness) përkufizohet si aftësi e materialit për të absorbuar energji dhe lejuar deformime plastike pa pësuar thyerje. Pra çeliku është i aftë të pranojë ngarkesa në mënyrë monotone, por mund të jetë i brishtë kur ngarkesa vepron shpejt që shkakton edhe thyerje. Pra rezistenca ndaj thyerjes së shpejtë njihet si qëndrueshmëri e materialit. Në pjesët 1-10 të Eurokodit 3 kemi udhëzimet rreth përzgjedhjes së çelikut (klasa S235-S690), sipas qëndrueshmërisë së materialit të përdorur në elementet e salduara në tërheqje dhe elemente nënshtruar lodhjes. Kjo karakteristikë klasifikohet si energji e absorbuar nga mostrat e testuara nga testi i goditjes. Si më e shpeshtë është testi i Sharpit (Charpy test).

1.4.4 Rezistenca ndaj lodhjes

Është e rëndësishme kur elementet dhe lidhjet e strukturës i nënshtrohen ngarkesave ciklike. Lodhja mund të shkaktojë dështim në detajet e strukturës edhe nëse niveli i sforcimeve është më i vogël sesa ato të kërkuara nga sforcimet e aplikuara në mënyrë të përsëritur. Pavarësisht mënyrës së veprimit në ngarkesave ciklike, pas një kohe konstruksioni shkatërrohet edhe pse sforcimet nuk e kanë arritur apo kaluar kufirin maksimal të rezistencës. Rezistenca ndaj lodhjes për pjesën më të madhe të detajeve në strukturat e çelikut duhet përputhur me pjesën 1-9 të Eurokodit 3.

1.4.5 Rezistenca nga korrozioni

Materialët nga çeliku në mjedise agresive, në prezencë të ujit dhe oksigjenit kanë tendencë t'i nënshtrohen procesit të korrozionit që mund të shkaktojë dëmtime në jetëgjatësinë e strukturës. Për parandalimin e këtij fenomeni, është esenciale që sipërfaqet e elementeve të çelikut të jenë rezistente ndaj korrozionit. Referuar EC3-1-1, në 2.1.3.1(1) kjo realizohet nëse: a) modifikohen karakteristikat e materialit bazë ose alizheve, duke prodhuar sipërfaqe të cilat janë rezistuese ndaj mjediseve koroduese (psh sipërfaqe metalike e trajtuar me oksid kromi) ose b) duke aplikuar mvëshjen e cila mund të jetë metalike ose jometalike.

1.5 Karakteristikat gjeometrike dhe tolerancat

Produktet kryesore të formuar në të nxehtë janë: profilet I, H, kutitë, U, T, L, pllakat etj. Është e mundshme që përmes saldimit të fitohen prerje tërthore të ndryshme. Gjithashtu përmes procesit të formimit në të ftohtë mund të formohen një gamë e gjerë e profileve.




Figura 3 Profilet e punuar nga prodhimi në të nxehtë




Figura 4 Profilet e formuara në të ftohtë

Produktet e çelikut që përdoren në strukturat metalike duhet të jenë brenda tolerancave gjeometrike (si në dimensione ashtu edhe për nga forma) duke u varur nga procesi i prodhimit të tyre. Këto produkte duhet t'i referohen standardit EN 1090-2. Tolerancat e dimensioneve për produktet I dhe H i referohen standardit EN 10034.

1.5.1 Klasifikimi i prerjeve tërthore sipas EC 3 (Eurokodi 3)⁴

Klasifikimi i prerjeve tërthore varet nga karakteristikat gjeometrike të elementeve (te profilet **I**, brezat dhe brinja e profilit) dhe gjendja e ngarkimit të tyre.

Klasa 1: Prerja tërthore ka mundësi të krijimit të momentit plastik dhe mundësi të mjaftueshme të rrotullimit për të krijuar çernierë plastike.

Klasa 2: Prerja tërthore ka mundësi të krijimit të momentit plastik, por mundësi të limituara të rrotullimit.

Klasa 3: Prerja tërthore ka mundësi të krijimit të momentit elastik dhe të rrjedhjes.

Klasa 4: Prerja tërthore ka mundësi të krijimit të momentit i cili është më i vogël se momenti elastik për shkak të paraqitjes së epjes lokale.

Klasifikimin e prerjeve e gjejmë në EC3, tabela 5.2

⁴ Mekanika e materialeve 1, Shtojca D, fq 601 (Arton D.Dautaj)

1.5.2 Klasifikimi i prerjeve tërthore që janë nën veprimin e përdredhjes⁵

Eurokodi 3 bën klasifikimin e prerjeve tërthore duke u bazuar në ndikimin e efekteve të qëndrueshmërisë lokale në reduktimin e rezistencës së prerjes tërthore. Ndarja bëhet:

Klasa 1- prerjet tërthore të cilat mundësojnë plasticizimin dhe krijimin e çernierave plastike në përdredhje deri në zhvillimin e mekanizmit të shkatërrimit

Klasa 2- tregon prerjet tërthore që janë të afta të zhvillojnë çernierën e parë, por jo për të zhvilluar mekanizmin e shkatërrimit, pasi mund të pengohen nga qëndrueshmëria lokale inelastike

Klasa 3- ka prerjet tërthore, në të cilat mund të fillojë rrjedhshmëria para se të ndodhë humbja e qëndrueshmërisë lokale

Klasa 4- prerjet tërthore që duhet të verifikohen në qëndrueshmëri lokale (pasi ato mund të humbasin qëndrueshmërinë para fillimit të rrjedhshmërisë).




Figura 5 Sjellja e prerjes tërthore ndaj momenteve

M_{el} - momenti elastik dhe M_{pl} - momenti plastik⁶

⁵ Mekanika e materialeve 1, Shtojca D, fq 602 (Arton D.Dautaj)

⁶ Design of steel structures, L.Simões da Silva and R. Simões

2. Eurokodi 8

Eurokodi 8 aplikohet për të projektuar dhe ekzekutuar vepra inxhinierike të cilat ndodhen në vende sizmike (EN 1998-1, 1.1.1). Në rast të tërmeteve, qëllimi është që të plotësohen plotësisht objektivat e projektimit:

-mbrojtja e jetës njerëzore

-kufizimi i dëmtimeve

-strukturat e rëndësishme të mbeten funksionale për mbrojtjen civile

Për struktura të veçanta si diga, centrale bërthamore, platforma detare duhet qasje shtesë.

EC8 ka 6 pjesë:

EN 1998-1 Aplikohet në projektimin dhe zbatimin e ndërtesave dhe veprave të inxhinierisë civile në zonat sizmike

EN 1998-2 Aplikohet për urat

EN 1998-3 Vlerësimi dhe riaftësimi sizmik i ndërtesave ekzistuese

EN 1998-4 Rezervuaret, siloset dhe tubacionet

EN 1998-5 Themelet, strukturat (muret) mbajtëse dhe aspektet gjeoteknike

EN 1998-6 Kulla, antena dhe oxhaqe

2.1 Eurokodi EN 1998-1⁷

EN 1998-1 është i ndarë në 10 Seksione, disa prej të cilave i kushtohen posaçërisht projektimit të ndërtesave.

Seksioni 1 përmban aspektet e përgjithshme, normativat referuese dhe simbolet

Seksioni 2 përmban kërkesat bazë të performancës dhe kriteret përkatëse të konformitetit të aplikueshme në ndërtesa dhe vepra të Inxhinierisë civile, në zonat sizmike.

Seksioni 3 jep rregullat për përfaqësimin (dhënien) e veprimeve sizmike, si dhe për kombinimin e tyre me veprimet e tjera. Disa tipa strukturash, të trajtuara në EN 1998-2 deri EN 1998-6, kanë nevojë për rregulla plotësuese që janë dhënë në ato Pjesë.

Seksioni 4 përmban rregullat e përgjithshme të projektimit, të lidhura në mënyrë specifike me ndërtesat.

⁷ Design of Steel Structures for Buildings in Seismic Areas (Raffaele Landolfo, Federico Mazzolani, Luis Simões da Silva, Mario D’Aniello)

Seksionet 5 deri në 9 të EN 1998-1 përmbajnë rregulla të veçanta për materiale dhe elementë të ndryshëm strukturorë, të përdorur në mënyrë specifike në ndërtesa, si në vijim:

- Seksioni 5: Rregulla të veçanta për ndërtesat prej betoni
- Seksioni 6: Rregulla të veçanta për ndërtesat prej çeliku
- Seksioni 7: Rregulla të veçanta për ndërtesat kompozite çelik-beton
- Seksioni 8: Rregulla të veçanta për ndërtesat prej druri
- Seksioni 9: Rregulla të veçanta për ndërtesat me muraturë.

Seksioni 10 përmban kërkesat themelore dhe aspekte të tjera të rëndësishme të projektimit dhe sigurisë, që kanë të bëjnë me izolimin në bazën (themelin) e strukturave dhe në mënyrë të veçantë, me izolimin në bazën e ndërtesave.

2.2 Kërkesat e performancës dhe kriteret e konfirmitetit

2.2.1 Kërkesat themelore

Në EC8-1 janë dy nivele që duhet merren parasysh gjatë projektimit të një strukture që korrespondojnë me objektivat e nevojshme:

-kërkesa e mosshembjes (no collapse requirement): të ruaj jetët njerëzore nga veprimet sizmike duke shmangur kolapsin lokal ose global të strukturës si dhe të ruaj integritetin strukturor me një kapacitet mbajtës të ngarkesave pas veprimeve sizmike.

-kërkesa për kufizimin e dëmtimeve: kufizimi i dëmtimeve në elementet strukturore dhe jostrukturore në rast të veprimeve të shpeshta sizmike.

2.2.2 Kombinimet e veprimit sizmik me veprimet tjera

Nga shprehja EC8-1 (pika 3.2.4.1(P)), E_d (vlera projektuese) e efekteve të veprimeve sizmike projektuese përcaktohet duke kombinuar vlerat korresponduese sipas skemës:

$$E_d = E \{G_{k,j}; P; A_{Ed}; \Psi_{2,i}; Q_{k,i}\} \quad j \geq 1; i \geq 1$$

Kombinimi i ngarkesave përdoret për gjendjen kufitare:

$G_{k,j}$ -vlera karakteristike e ngarkesës së përhershme

$Q_{k,i}$ -vlera karakteristike e ngarkesës së përkohshme

A_{Ed} -vlera e projektuar e ngarkesës sizmike $A_{Ed} = \gamma_I \times A_{Ek}$

A_{Ek} -vlera karakteristike e ngarkesës sizmike për periodën e përsëritjes së referencës

P - vlera e veprimit nga parandëria (nëse ekziston)

$\Psi_{2,i}$ - koeficienti për vlerat kuazi-permanent për ngarkesat e përkohshme (Tabela 2.4, EN1990)

γ_I – koeficienti i rëndësisë

Efektet inerciale të veprimit projektues sizmik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh prezencën e masave, shoqëruar me gjithë ngarkesat që shfaqen në kombinimin e veprimeve:

$$\sum_{j \geq 1} G_{k,j} + \sum_{j \geq 1} \Psi_{E,i} Q_{k,i}$$

$G_{k,j}$ -është vlera karakteristike e ngarkesës së përhershme të j-të

$Q_{k,i}$ -është vlera karakteristike e ngarkesës së ndryshueshme të j-të

$\Psi_{E,i}$ - është factor i kombinimit të masës që i korrespondon veprimit të ndryshueshëm të i-të për situatën projektuese sizmike

$$\Psi_{E,i} = \phi \Psi_{2,i}$$

$\Psi_{2,i}$ -merret nga EN 1990 sipas kategorive të ngarkesave (tabela 4.-4)

ϕ – koeficient nga EN 1998-1, tabela 4.2

2.3 Karakteristikat e strukturës për rezistencë ndaj tërmetit

2.3.1 Parimet bazë të projektimit konceptual

-thjeshtësia strukturore (4.2.1.1(1)) nënkupton rrugën e drejtpërdrejt të kalimit të ngarkesës për transmetimin e ngarkesave sizmike nga pjesa e sipërme deri në themele.

-uniformiteti, simetria dhe pacaktueshmëria (4.2.1.2): uniformiteti në plan nënkupton shpërndarje të barabartë të elementeve strukturorë që mundësojnë transmetim direkt dhe më të shpejtë të inercisë së masave të shpërndara të ndërtesës. Kur objekti ka konfiguracion gati simetrik si dhe elementet strukturorë kanë simetri në shpërndarje dhe pozicionim kontribuohet që të kemi uniformitet.

-rezistenca dhe ngurtësia në dy drejtime (4.2.1.3): struktura duhet të jetë e aftë t'i rezistojë veprimeve horizontale në cilindo drejtim. Elementet strukturorë të vendosen në plan ashtu që të kenë ngurtësi dhe rezistencë në dy drejtime.

- *rezistenca dhe ngurtësia në përdredhje (4.2.1.4(1))*: struktura duhet të posedojë rezistencë dhe ngurtësi adekuate ndaj përdredhjes në mënyrë që të kufizojë lëvizjet përdredhëse të cilat tentojnë të sforcjnë elementet e ndryshëm strukturorë në mënyrë jouniforme.

- *sjellja diafragmatike në kate (4.2.1.5)*: katet (duke përfshi kulmin) duhet të sillen si diafragma horizontale që marrin dhe transmetojnë forcat inerciale në elementet vertikal strukturorë dhe sigurojnë që sistemi sillet si tërësi në rezistencën e veprimeve horizontale sizmike.

- *themele adekuate (4.2.1.6)*: themelet kanë rol kyç, pasi ato sigurojnë që ndërtesa t'i nënshtrohet një ngacmimi sizmik uniform.

2.3.2 Elementet parësor dhe sekondarë sizmik

EC8-1, 4.2.2 në mënyrë eksplicite bën dallim ndërmjet elementeve strukturorë primar dhe sekondar si dhe rolin e tyre ndaj veprimeve sizmike.

Elementet që kontribuojnë në rezistencën sizmike të strukturës konsiderohen primar, ndërsa elmenentet sekondarë kanë për detyrë t'i rezistojnë ngarkesave gravitacionale. Pra kontributi i elementeve sekondarë ndaj veprimeve sizmike neglizhohet, ndërsa ato duhet pasur aftësi për ngarkesa gravitacionale nga projektimi sizmik. Ky kusht duhet plotësuar duke kontrolluar forcat në këto elemente nga ngarkesa më e pafavorshme sizmike, duke konsideruar poashtu ndikimin e efekteve të rendit të dytë (p.sh. efektin P- Δ) pra duke mos tejkaluar aftësinë mbajtëse.

2.4 Kriteri i strukturës për rregullësi

Struktura duhet të jetë e rregullt në plan dhe lartësi. Konceptet kryesore janë në EC8-1 në 4.2.3 që specifikon kriteret thelbësore në mënyrë që të kemi struktura të rregullta.

Duhet nënvizuar që klasifikimi i strukturave sipas rregullsisë përfshinë disa aspekte të projektimit sizmik si:

- modeli strukturor, mund të jetë ose model-plan i thjeshtuar ose model hapësinor
- metoda e analizës, mund të jetë ose një analizë e thjeshtuar sipas spektrit të reagimit (metoda e forcave anësore) ose një analizë modale
- vlera e faktorit të sjelljes q , i cili duhet të zvogëlohet për ndërtesat jo të rregullta në lartësi

Sipas kësaj qasje EC8-1 nuk e përjashton projektimin e strukturave të parregullta, por dekurajon përdorimin e konfiguracioneve të parregullta, duke imponuar metoda më të sofistikuar të cilat janë më të shtrenjta karshi forcave projektuese me të mëdha (p.sh. imponohet reduktimi i faktorit të sjelljes).

2.4.1 Krite për rregullsinë në plan

Që struktura të kategorizohet e rregullt në plan, ajo duhet të kënaqë kushtet:

- Përsa i përket ngurtësisë anësore dhe shpërndarjes së masave, struktura e ndërtesës duhet të jetë afërsisht simetrike në plan sipas dy akseve ortogonale
- Konfiguracioni në plan duhet të jetë kompakt
- Ngurtësia në plan e ndërkateve duhet të jetë mjaftueshëm më e lartë se ngurtësia anësore e elementeve strukturore vertikale, ashtu që deformimi i katit të ketë efekt të vogël në shpërndarjen e forcave ndërmjet elementeve strukturore vertikale.
- Përkulshmëria $\lambda = L_{\max}/L_{\min}$ e ndërtesës në plan duhet të jetë jo më e madhe se, ku $L_{\max}$ dhe $L_{\min}$ janë dimensionet më të mëdha dhe më të vogla në plan
- Në çdo nivel dhe për çdo drejtim të analizës, x ose y, jashtëqendërsia strukturore e_0 dhe rrezja e përdredhjes r duhet të kënaqin të dyja kushtet e mëposhtme, të shprehura për drejtimin “y” të analizës:

$$e_{0x} \leq 0.3r_x$$

$$r_x \geq l_x$$

e_{0x} është largësia ndërmjet qendrës së masës dhe ngurtësisë, të matur sipas drejtimin x, i cili është normal me drejtimin e analizës së konsideruar,

r_x është rrënja katrore e raportit ndërmjet ngurtësisë në përdredhje dhe ngurtësisë anësore në drejtimin y (“rrezja përdredhëse”)

l_x është rrezja e inercisë e masës së ndërkatit në plan

Duhet thekësuar që shumica e strukturave të rregullta në plan, dy periodat e para të lëkundjeve i takojnë zhvendosjeve në dy drejtimet kryesore x dhe y. Kjo sjellje garantohej nga ekuacioni i sipërshënuar e cila e shmangë përdredhjen me zhvendosje e cila konsiderohet e pakontrollueshme dhe potencialisht e rrezikshme. Ekuacioni i mësipërm konsiderohet i plotësuar në tërësi nëse perioda e lëkundjes përdredhëse është më e vogël se perioda e

zhvendosjes në dy drejtimet horizontale. Poashtu në mënyrë që sistemi tu bëjë rezistencë forcave anësore, është e rëndësishme që pozita më e përshtatshme e pozicionimit të elementeve rezistuese sizmike (shtangimet, muret) është perimetri. Në të kundërtën, nëse sistemi rezistues është i koncentruar në qendër të pllakës, ekuacioni i mësipërm mund të mos plotësohet.

Për klasifikimin e rregullësisë strukturore në plan dhe për analizën e përafshuar të efekteve të përdredhjes mund të jepet një përkufizim i thjeshtuar, nëse kënaqen kushtet:

- të gjitha elementet rezistuese ndaj veprimeve anësore (bërthamat, muret strukturore ose ramat) vazhdojnë pa ndërprerje nga themelet deri në fund të objektit

- forma e zhvendosjeve të sistemeve të veçuar për shkak të ngarkesave horizontale nuk janë shumë të ndryshme midis tyre. Ky kusht mund të konsiderohet plotësisht i plotësuar në rastin e sistemeve me rama dhe sistemeve me mure. Në përgjithësi ky kusht nuk plotësohet në sistemet duale.

2.4.2 Kriteri për rregullësi në lartësi

EC8-1 (4.2.3.3) e konsideron një strukturë si të rregullt në lartësi nëse plotësohen kriteret:

- të gjitha sistemet rezistuese ndaj veprimeve anësore (bërthamat, muret ose ramat) duhet të vazhdojnë pa ndërprerje nga themelet deri në kreun e objektit.

- ngurtësia anësore dhe masa e secilit kat duhet të mbeten konstante ose të reduktohen gradualisht, pa ndryshime të theksuara nga baza deri në kreun e objektit.

- në ndërtesat me rama, raporti i rezistencës reale të katit kundrejt rezistencës së kërkuar nga analiza të mos ndryshojë në mënyrë të disproporcionuar midis kateve fqinje.

2.4.2.1 Pasojat e rregullësisë strukturore në analizën sizmike

Rregullësia në plan dhe lartësi ndikon në sjelljen e strukturës. Rregullësia e strukturës ndikon në jashtëqendërsinë ndërmjet qendrës së masës (CM-centre of mass) dhe qendrës së shtangësisë (CS-center of stiffness) duke siguruar efektin minimal në përdredhje. Me këtë rast, forcat sizmike veprojnë në drejtimin ku janë të pozicionuar sistemet rezistuese sizmike. Strukturat të cilat janë të parregullta në plan përfshijnë efektin e përdredhjes, kështu që sistemi rezistues sizmik nuk është i ngarkuar në mënyrë uniforme nga veprimi i forcave sizmike.




Figura 6 Pasojat e rregullsisë në plan: a) strukturë e rregullt, b) strukturë e pa rregullt

Për strukturat e rregullta në lartësi që nuk janë shumë fleksibile (perioda e lëkundjeve T_i është më e vogël sesa minimumi ndërmjet $4T_c$ dhe 2s). Këto stuktura analizohen me metodën e forcave anësore. Ndërsa për strukturat e parregullta në lartësi që karakterizohen me lëkundje me forma më të larta të lëkundjeve analizohen duke përdorur analizën modale të spektrit të reagimit.

2.5. Metodatat për analiza sismike

Veprimet sismike të aplikuar në strukturë llogariten duke përdorur metodat e dinamikës së strukturave, nga shpejtimet e imponuara në strukturë në nivelin e tokës në formë të tre komponentëve translativë të cilat aplikohen uniformisht në të gjitha pikat e mbështetjes. Sipas EC-1 (4.3.3) analiza e tipeve të strukturave mund të llogaritet dhe verifikohet në njërin prej formave:

- metoda e analizave sipas forcave anësore
- analiza modale sipas spektrit të reagimit
- analiza jolineare statike “pushover” (“e mbingarkimit gradual”)
- analiza jolineare dinamike

2.5.1 Metoda e analizës sipas forcave anësore

Kjo metodë aplikohet në ndërtesa, reagimi i të cilave nuk mund të preket në mënyrë të konsiderueshme nga kontributi i toneve të lëkundjeve më të larta se toni themelor për çdo drejtim kryesor. E kjo plotësohet nëse ndërtesat kënaqin kushtet:

- kanë periode themelore të lëkundjeve T_1 në dy drejtimet kryesore më të vogla se vlerat:

$$T_1 \leq 4T_c$$

$$T_1 \leq 2s$$

-plotësohet kushti i rregullësisë në lartësi

Llogaritja e forcave sizmike përcaktohet në dy hapa: llogaritja e forcës prerëse në bazë dhe shpërndarja e forcave sizmike horizontale.

Për secilin drejtim horizontal ndaj të cilit analizohet ndërtesa, forca prerëse sizmike në bazë F_b përcaktohet sipas shprehjes

$$F_b = S_d(T_1) m \lambda$$

$S_d(T_1)$ - është ordinatë e spektrit të reagimit

T_1 - është perioda themelore e lëkundjeve të ndërtesës për lëvizje anësore në drejtimin e konsideruar

m - është masa totale e ndërtesës, sipër themelit ose sipër kreut të një bodrumi rigjid

λ - është faktor korrektues, $\lambda=0.85$ nëse $T_1 \leq 2T_c$ dhe ndërtesa ka më shumë se dy kate, ose $\lambda=1.0$ në çdo rast tjetër

$$T_1 = C_t H^{3/4}$$

$C_t=0.085$ për ramat hapësinore moment-rezistuese prej çeliku

$C_t=0.075$ për ramat hapësinore moment-rezistuese prej betoni dhe për ramat prej çeliku me kontraventime ekscentrike

$C_t=0.05$ të gjitha strukturat tjera

H - lartësia e ndërtesës nga themeli ose nga kreu i një bodrumi rigjid, e matur në m'

2.5.2 Shpërndarja e forcave sizmike horizontale

Forma e tonit themelor në drejtimin horizontal të analizës së ndërtesës mund të llogariten duke përdorur metodat e dinamikës së strukturave, ose mund të merren me përafrim nëpërmjet zhvendosjeve horizontale që rriten linearisht në lartësinë e ndërtesës.

Efektet e veprimit sizmik duhet të përcaktohen duke aplikuar në të gjitha katet për të dy modelet plane, forca horizontale F_i , e përcaktuar nga:

$$F_i = F_b \frac{s_i m_i}{\sum s_j m_j}$$

F_i - forca horizontale që vepron në katin i

F_b - forca prerëse në bazë

s_i, s_j - zhvendosjet e masave m_i, m_j për formën e tonit themelor

m_i, m_j - masat e kateve

Kur forma e tonit themelor përafrohet nga zhvendosjet horizontale që rriten linearisht në lartësi, forcat horizontale F_i këshillohet të merren nga:

$$F_i = F_b \frac{z_i m_i}{\sum z_j m_j}$$

z_i, z_j janë lartësitë e masave m_i, m_j sipër nivelit (themelit ose kreut të një bodrumi rigid) të aplikimit të veprimit sizmik

2.5.3 Analiza modale sipas spektrit të reagimit

Duhet të merret parasysh reagimi i të gjitha toneve të lëkundjeve që kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në reagimin total. Ky parim konsiderohet i plotësuar në përmbushen kushtet vijuese në çdo drejtim horizontal kryesor:

- shuma e masave modale efektive të formave të lëkundjeve të marra parasysh është të paktën sa 90% e masës totale të strukturës

- janë marrë parasysh të gjitha tonet e lëkundjeve me masa modale efektive më të mëdha se 5% të masës totale.

2.5.4 Analiza statike jolineare (pushover)

Kjo analizë kryhet duke aplikuar veprimin e ngarkesave të përhershme vertikale dhe duke rritur gradualisht ngarkesat anësore të cilat afërsisht përfaqësojnë forcat nga veprimi i tërmetit. Kjo analizë mund të aplikohet për të verifikuar performancën e ndërtesave të sapo projektuara dhe të ndërtesave ekzistuese për këto qëllime:

- për të verifikuar ose rishikuar vlerat e raportit të mbirezistencës

- për të vlerësuar mekanizma plastikë të pritshëm dhe shpërndarjen e dëmtimve

- për të vlerësuar performancën strukturore të ndërtesave ekzistuese ose të riaftësuara për qëllimet e EN 1998-3

- si një alternativë kundrejt projektimit të bazuar në analizën lineare-elastike që përdor faktorin e sjelljes q .

2.5.5 Analiza jolineare në fushën kohore (“time-history analysis”)

Reagimi si funksion kohor i strukturës mund të përfitohet përmes integritit numerik të drejtpërdrejtë të ekuacioneve diferenciale të lëvizjes, duke përdorur akselerograma (EN 1998-1). Normat rekomandojnë që në analizën “time-history” të merren parasysh disa tërmete (të regjistruara) në mënyrë që të fitohen më tepër të dhëna rreth reagimit të strukturës, e cila do të rrisë probabilitetin e reagimit pozitiv në tërmetet e ardhshme.⁸

2.6. Përdredhja aksidentale

2.6.1 Ekscentriciteti aksidental

Edhe pse EC8-1 inkurajon që struktura të jetë e rregullt në plan dhe lartësi, shumë objekte nuk mund t'i gëzojnë këto kushte optimale për shkak të kërkesave estetike ose funksionit të kërkuar. Dihet që struktura me shpërndarje të parregullt të masës ose shtangësisë në kat kontribuon në përdredhje. Përdredhja më e saktë vërehet në modelet tri dimensionale, sidomos kur analiza e spektrit të reagimit apo analiza jolineare ose lineare përvetësohet.

Në çfarëdo tipi analize të përdorur, një përdredhje aksidentale duhet të merret parasysh në llogari. Kjo bëhet nga aplikimi i një jashtëqendërsie shtesë të masave në nivel të ndryshme. Sipas 4.3.2(1)P ekscentriciteti aksidental jepet me shprehjen:

$$e_{ai} = \pm 0.05 L_i$$

L_i - gjatësia e pllakës normal në veprimin e veprimit sizmik

2.6.2 Efekti i përdredhjes aksidentale me analizën e forcave anësore

Metoda e forcës anësore është metoda më e thjeshtë për analizë sismike dhe një përafrim i thjeshtuar për efektin e përdredhjes aksidentale.

⁸ Arkitektura sismike fq 92




Figura 7 Efektet e rrotullimit të simuluar nga faktori δ

Nëse ngurtësia dhe masa anësore janë shpërndarë simetrikisht në plan, një alternativë ndryshe nga modeli hapësinor është amplifikimi i efekteve sismike (forcat e brendshme ose zhvendosjet) në elementin individual rezistues ndaj ngarkesave në një distancë x nga qendra e gravitetit nga një koeficient amplifikimi δ .

Nga 4.3.3.2.4(1) kemi shprehjen: $\delta = 1 + 0.6x/L_e$

x - distanca e elementit në konsideratë nga qendra e masës së ndërtesës në plan, e matur normal me drejtimin e veprimit sismik të konsideruar

L_e -distanca ndërmjet dy elementëve ekstremë të planit që janë pjesë e sistemit rezistues ndaj ngarkesave anësore, matur normal me drejtimin e veprimit sismik të konsideruar

2.6.3 Përdredhja aksidentale me analizën e spektrit të reagimit

Në rastet kur për analizë përdoret një model hapësinor, efektet e përdredhjes aksidentale mund të përcaktohen nga vlerat më të mëdha të efekteve që rezultojnë nga aplikimi i ngarkesave statike, të cilat konsistojnë në serinë e momenteve përdredhëse M_{ai} të aplikuara rreth aksit vertikal në çdo kat i .

$$M_{ai} = e_{ai} F_i$$

M_{ai} - momenti përdredhës i aplikuar në katin i rreth aksit të tij vertikal

e_{ai} - jashtëqëndërsia aksidentale e masës së katit i

F_i - forca horizontale vepruese në katin i




Figura 8 Jashtqendërsia aksidentale nga momentet përdredhëse të aplikuara në qendrën e masës të çdo kati

2.7 Kombinimi i efekteve të komponenteve të veprimit sizmik

Veprimi sizmik karakterizohet nga 3 komponente të zhvendosjes ortogonale (dy horizontale dhe një vertikale) që veprojnë njëkohësisht (komponenta e rrotullimit në të shumtën e rasteve neglizhohet). Kombinimi i komponentëve horizontal të veprimit sizmik mund të merret parasysh si:

-reagimi strukturor ndaj secilit komponent duhet të vlerësohet në mënyrë të veçantë, duke përdorur rregullat e kombinimit për reagimet modale

-vlera maksimale e secilit efekt veprimi në strukturë për shkak të dy komponenteve horizontal të veprimit sizmik, mund të vlerësohet më tej nëpërmjet rrënjës katrore të shumës së katrorëve të vlerave të veprimit për shkak të secilit komponent horizontal

$$E = \sqrt{E_{Edx}^2 + E_{Edy}^2}$$

-efektet e veprimit për shkak të kombinimit të komponentëve horizontal të veprimit sizmik mund të llogariten duke përdorur kombinimet vijuese:

$$E_{Edx} + 0.3E_{Edy}$$

$$0.3E_{Edx} + E_{Edy}$$

2.8. Llogaritja e zhvendosjeve

Nëse kryhet analizë lineare, zhvendosjet që shkakton veprimi sizmik projektues duhet të llogariten në bazë të deformimeve elastike të sistemit strukturor nëpërmjet shprehjes:

$$d_s = q_d d_e$$

d_s - zhvendosja e një pike të sistemit strukturor e shkaktuar nga veprimi sizmik projektues

q_d - faktori i sjelljes i zhvendosjes, i supozuar si i barabartë me q nëse nuk specifikohet

d_e- zhvendosja e së njëjtës pikë të sistemit strukturor, e përcaktuar sipas analizës lineare

Gjatë përcaktimit të zhvendosjeve d_e, duhet të merren parasysh efektet e përdredhjes të veprimit sizmik.

Për analizë jolineare, si statike ashtu edhe dinamike vlerat e zhvendosjeve janë ato që përfitojnë drejtpërdrejtë nga analiza përkatëse, pa modifikime të mëtejshme.

2.9 Efektet e rendit të dytë në analizën sizmike linear elastike

Një aspekt tjetër që duhet merret parasysh është edhe ndikimi efekteve të rendit të dytë (P-Δ) në stabilitetin e ramit. Në të vërtetë, në raste të deformimeve të mëdha anësore, ngarkesat gravituese vertikale mund të ndikojnë në deformimin e konfiguracionit të strukturës. Kjo shkakton rritjen e deformimeve dhe forcave në strukturë që mund të rezultojë me kolaps nga veprimet sizmike.

Efektet e rendit të dytë (P-Δ) nuk janë të nevojshme të merren parasysh nëse të gjitha katet përmbushet kushti:

$$\theta = \frac{P_{tot}d_r}{V_{tot}h} \leq 0.1$$

θ- koeficient i ndjeshmërisë, referuar driftit të kateve

P_{tot}- ngarkesa peshë totale në katin dhe sipër katit të konsideruar, në situatën sizmike projektuese

d_r- drifti projektues i kateve, i vlerësuar si diferenca e zhvendosjeve mesatare anësore d_s në nivelin më të lartë dhe atë më të ultë të katit në shqyrtim

V_{tot}- forca prerëse totale sizmike e katit

h- lartësia e katit

Nëse **0.1 < θ ≤ 0.2** efektet e rendit të dytë mund të merren parasysh me përafërsi, duke shumëzuar efektet përkatëse të veprimit sizmik me një faktor të barabartë **1/(1-θ)**.

θ ≤ 0.3

θ ≤ 0.1 efektet e rendit të dytë mund të neglizhohen

3. Kontrolla e projektimit

Kërkesa e mosshembjes (ULS-gjendja e fundit kufitare) në situatën sizmike të projektimit konsiderohet që është plotësuar nëse plotësohen kushtet: rezistenca, duktiliteti, ekuilibri, qëndrueshmëria e themelit dhe nyjet sizmike.

3.1 Kushti i rezistencës

Për të gjithë elementët strukturorë përfshirë bashkimet dhe elementet e duhur jostrukturorë duhet të kënaqet kushti vijues:

$$E_D \leq R_D$$

E_D –vlera projektuese e efektit të veprimit për shkak të situatës sizmike projektuese duke përfshirë nëse është e nevojshme edhe efekti i rendit të dytë.

R_D –është rezistenca korresponduese projektuese e elementit, e llogaritur në përputhje me rregullat specifike për materialin e përdorur

3.2 Kushti i duktilitetit global dhe lokal

Duke marrë parasysh shfrytëzimin e pritshëm të duktilitetit që varet nga sistemi i zgjedhur dhe faktori i sjelljes duhet të verifikohet që elementet strukturorë dhe struktura në tërësi të zotërojnë një duktilitet adekuat. Përveç kësaj, një veçori tjetër e rëndësishme është koncepti dhe ekzekutimi i detajeve lokale. Poashtu përzgjedhja e vetive të materialeve të cilat parandalojnë shkatërrimin e thyeshëm lokal.

Në ndërtesa shumëkatëshe duhet shmangur formimin e mekanizmit plastik të tipit “kati i butë”, pasi një mekanizëm i tillë për shtyllat e “katit të butë” mund të kërkojë duktilitet lokal jashtëzakonisht të madh. Në ndërtesat me rama, duke përfshirë ato ekuivalente me rama që kanë dy ose më shumë kate në të gjitha nyjet ku lidhen trarët parësor ose dytësorë lidhen me shtyllat parësore sizmike duhet të kënaqet kushti:

$$\Sigma M_{Rc} \geq 1.3 \Sigma M_{Rb}$$

ΣM_{Rc} –është shuma e vlerave projektuese të momenteve rezistuese të shtyllave që hyjnë në nyje. Këshillohet që të përdoret vlera minimale e momenteve rezistuese brenda intervalit të forcave aksiale në shtylla të shkaktuara nga situata sizmike projektuese.

ΣM_{Rb} – është shuma e vlerave projektuese të momenteve rezistuese të trarëve që hyjnë në nyje. Nëse përdoren bashkime me rezistencë të pjesshme, atëherë në llogaritjen e ΣM_{Rb} merren parasysh momentet e rezistencës së këtyre bashkimeve.

3.3 Kushti i ekuilibrit

Veprimet nga projektimi sizmik karakterizohen nga forcat horizontale anësore. Është e nevojshme që të eliminohet humbja e përgjithshme e stabilitetit ndaj rrotullimit apo edhe rrëshqitjes të ndikuara nga këto veprime. Kështu, struktura duhet të jetë e qëndrueshme duke përfshirë përmbysjen dhe rrëshqitjen. Në raste të veçanta, ekuilibri mund të verifikohet nëpërmjet metodave të balancit energjetik ose nëpërmjet metodave jolineare të karakterit gjeometrik.

3.4 Rezistenca e diafragmave horizontale

Rekomandohet që pllakat e katit dhe kulmit të konsiderohen si diafragma që të jenë në gjendje të transmetojnë me mbirezistencë të mjaftueshme, efektet e veprimit sizmik projektues në sistemet rezistuese ndaj ngarkesave anësore me të cilat ato janë lidhur. Kjo kërkesë plotësohet nëse verifikimet përkatëse të rezistencës, efektet e veprimit sizmik për diafragmën shumëzohen me një faktor mbirezistence $\gamma_d > 1.0$. Vlera e rekomanduar për mënyrat e shkatërrimit të tipit të thyeshëm sikurse është prerja në diagragmat prej betoni është $\gamma_d = 1.3$ ndërsa për mënyrat e shkatërrimit duktil është $\gamma_d = 1.1$.

3.5 Rezistenca e themeleve

Sistemi i themelit duhet të jetë në përputhje me EN 1998-5, Seksioni 5 dhe EN 1997-1.

Efektet e veprimit për elementet e themeleve duhet të nxirren mbi bazën e konsideratave të projektimit sipas kapaciteteve, duke marrë parasysh shfaqjen e mbirezistencës së mundshme, por nuk është e nevojshme që ato t'i kapërcejnë efektet e veprimit që i korrespondojnë reagimit të strukturës në kushtet e situatës sizmike projektuese, duke respektuar supozimin e një sjelljeje elatike ($q=1.0$). Për themelet e elementeve vertikale të veçuara (mure ose shtylla) konsiderohet që këto kërkesa janë plotësuar nëse vlerat projektuese të efekteve të veprimit E_{Fd} mbi themel nxirren:

$$E_{Fd} = E_{F,G} + \gamma_{Rd} \Omega E_{F,E}$$

γ_{Rd} –faktor i mbirezistencës, $\gamma_{Rd}=1.0$ nëse $q \leq 3.0$ përndryshe $\gamma_{Rd}=1.2$

$E_{F,G}$ – efekti i veprimit për shkak të veprimeve josizmike të përfshira në kombinimin e veprimeve për situatën sizmike të projektimit.

$E_{F,E}$ –efekti i veprimit nga analiza për veprimin sizmik projektues

Ω – është vlera e $R_{di}/E_{di} \leq q$ e zonës disipuese ose elementit të strukturës që ka ndikimin më të lartë në efektin E_F në shqyrtim

R_{di} -është rezistenca projektuese e zonës ose elementit i

E_{di} -është vlera projektuese e efektit të veprimit në zonën ose elementin i për situatën sizmike projektuese

Për themelet e mureve strukturore ose shtyllave të ramave me nyje moment-rezistuese (“moment-resisting frames”), Ω është vlera minimale e raportit M_{Rd}/M_{Ed} në të dyja drejtimet kryesore ortogonale në prerjen tërthore më të ultë të elementit vertikal ku mund të formohet çernierë plastike, gjatë situatës sizmike projektuese.

3.6 Kushti i fugave sizmike

Ndërtesat duhet të jenë të mbrojtura nga përplasja që mund të ndodhë gjatë tërmetit mes strukturave fqinje ose nga goditja ndërmjet njësive të pavarura nga ana strukturore të së njëjtës ndërtesë. Kushtet që duhet të plotësohet janë:

-për ndërtesat e pavarura nga ana strukturore, të cilat nuk i përkasin të njëjtës pronësi, nëse largësia nga vija e pronësisë deri te pikat potenciale të goditjes nuk është më e vogël se zhvendosja horizontale maksimale e ndërtesës në nivelin korrespondues

-për ndërtesat e pavarura nga ana strukturore që i përkasin të njëjtës pronësi, nëse largësia ndërmjet tyre nuk është më e vogël se rrënja katrore e shumës së katrorëve (SRSS) të zhvendosjeve maksimale horizontale të të dyja ndërtesave ose njësive në nivelin korrespondues.

Nëse lartësitë e kateve të ndërtesës ose e njësisë së pavarur në shqyrtim janë të njëjta si ato të ndërtesës ose njësisë fqinje, atëherë largësia minimale e referuar më sipër mund të reduktohet nga një faktor i barabartë me 0.7.

3.7 Kufizimi i dëmtimeve

Në filozofinë e projektimit sizmik, kufizimi i dëmtimeve është aspekt thelbësor që garanton efikasitet të plotë strukturës nën ndikimin e tërmeteve të shpeshta si dhe të reduktojë koston e riparimit nga ngjarje të mëdha sizmike. Kërkesa e kufizimit të dëmtimeve konsiderohet e plotësuar nëse për një veprim sizmik që ka një probabilitet të madh ndodhjeje sesa veprimi projektues sizmik që i korrespondon “kërkesës së mosshembjes”. Në rastin e ndërtesave të

rëndësishme të mbrojtjes civile ose të atyre që kanë pajisje të ndjeshme, lidhur me kufizimin e dëmtimeve, mund të kryhen verifikime shtesë.

3.7.1 Kufizimi i drifteve të kateve

$d_r v \leq 0.005h$ për ndërtesat që kanë elemente jostrukturore me materiale të thyeshme dhe që janë të bashkangjitura me strukturën.

$d_r v \leq 0.0075h$ për ndërtesat që kanë element jostrukturorë duktile

$d_r v \leq 0.01h$ për ndërtesat që kanë elemente jostrukturor të fiksuar në mënyrë të tillë që nuk ndikojnë në deformimet strukturore ose që janë pa elemente jostrukturore.

d_r -është drifti projektues i kateve

h - lartësia e kateve

v - faktor reduktues që merr parasysh periudhën më të ultë të rikthimit të veprimit sizmik që lidhet me kërkesën e kufizimit të dëmtimeve. (Vlerat e rekomanduara janë $v=0.4$ për klasat e rëndësisë III dhe IV dhe $v=0.5$ për klasat e rëndësisë I ose II).

Në filozofinë moderne të projektimit sizmik i bazuar në performancë (PBSD, Performance Based Seismic Design), niveli i përfomancës së kontrollit të dëmit është thelbësor që të garantojë funksionim të plotë të strukturës nga tërmetet. Në anën tjetër të reduktojë koston e riparimit ndaj veprimeve sizmike. Kjo kërkesë është shfaqur për shkak të rritjes së vazhdueshme të strukturave moderne dhe komplekse.⁹

⁹ Elide Nastri, Alessandro Pisapia Performance-Based Seismic Design, 2025

4. Projektimi i strukturave të çelikut

4.1 Objektivat e projektimit të strukturave¹⁰

Objektivi i projektimit është që të prodhohet një strukturë e cila do të jetë e shfrytëzueshme për vite ose të mos kolapsojë, të përmbushë kërkesat dhe nevojat e investitorit si dhe të ketë kosto të arsyeshme poashtu.

Si kërkesa bazë mund të përmendim:

- struktura nuk duhet të kolapsojë lokalisht apo në përgjithësi
- të mos jetë fleksibile aq sa deformimet nga ngarkesat të dëmtojnë pjesët e brendshme
- të mos shfaqet nevoja për mirëmbajtje ekskluzive si shkak i mbingakesave aksidentale ose nga veprimet e kushteve atmosferike
- të ketë rezistencë ndaj zjarrit ashtu që ofrojë kohë të mjaftueshme për evakuim.

Projektuesi duhet të ketë parasysh koston e cila përfshinë:

- shpenzimet fillestare si përgatitja e vendpunishtes, koston e materialit dhe ndërtimit
- koston e mirëmbajtjes (dekorimet dhe riparimet)
- sigurimet që lidhen me rezistencën ndaj zjarrit
- demolimin eventual

Filozofia dhe objektivat duhet të përkthehen në formë të prekshme duke përdorur llogaritjet. Pra struktura të jetë e sigurtë nga të gjitha kushtet ose të jetë e përdorshme për sa ajo ekziston.




Figura 9 Skema e raportit ndërmjet veprimeve dhe rezistencës në strukturë

¹⁰ Structural design of steelwork (Lawrence Martin, John Purkins)

4.2 Tipologjitë e strukturave dhe faktorët e sjelljes

4.2.1 Tipet e strukturave

Ndërtesat prej çeliku grupohen në një prej tipeve strukturorë dhe klasifikohen sipas sjelljes së sistemeve rezistuese të elementeve primar sizmik:

-Ramat moment-rezistuese: janë ato në të cilat forcat horizontale përballohen kryesisht nga elementet që punojnë kryesisht në përkulje. Këshillohet që zonat disipuese të formohen kryesisht në çernierat plastike në trarë ose në bashkimet tra-kolonë në mënyrë që energjia të disipohet me anë të përkuljes ciklike. Zonat disipuese mund të formohen edhe në kolona: në bazë të ramës, në majë të kolonave në katin e sipërm të ndërtesave shumëkatëshe, në kreun dhe në fund të kolonave në ndërtesat njëkatëshe në të cilat N_{Ed} në kolona kënaqë barazimin $N_{Ed}/N_{pl,Rd} < 0.3$




Figura 10 Ramat moment-rezistuese

-Ramat me kontraventime koncentrike (“concentric bracings”): janë ato në të cilat forcat horizontale përballohen kryesisht nga elementet që u janë nënshtruar forcave aksiale. Këshillohet që zonat disipuese të formohen kryesisht te diagonalet e tërhequra. Kontraventimet mund t’i përkasin njërës prej kategorive:

-kontraventime diagonal aktive në tërheqje në të cilat forcat horizontale mund të përballohen vetëm nga diagonalet e tërhequra, pa marrë parasysh diagonalet e shtypura

-kontraventimet V, në të cilat forcat horizontale mund të përballohen duke marrë parasysh si diagonalet e tërhequra ashtu edhe ato të shtypura. Pika e ndërprerjes e këtyre diagonaleve bie në elementin horizontal, që duhet të jetë i vazhduar.




Figura 11 Rama me kontraventime diagonale koncentrike (zonës disipuese vetëm në diagonalet e tërhequra)

-Ramat me kontraventime ekscentrike (eccentric bracings): janë ato ku forcat horizontale përballohen kryesisht nga elemente të ngarkuar me forca aksiale, por ku jashtëqendërsia e skemës është e tillë që energjia mund të disipohet në hallkat sizmike ose nëpërmjet përkuljes ciklike ose nëpërmjet prerjes ciklike.




Figura 12 Ramat me kontraventime ekscentrike

-Struktura lavjerrësi i përmbysur: janë strukturat në të cilat zonat disipuese janë lokalizuar në bazat e shtyllave. Mund të konsiderohen si rama moment-rezistuese me kusht që strukturat rezistente ndaj tërmetit të kenë më shumë se një shtyllë në çdo plan rezistues dhe mosbarazimi i kufizimit të forcës aksiale: $N_{Ed} < 0.3 N_{pl,Rd}$ të kënaqet në çdo shtyllë.




Figura 13 Lavjerrësi i përmbysur: a) zona disipuese në bazë të shtyllës, b) zona disipuese në shtylla ($N_{Ed} < N_{pl,Rd} < 0.3$)

-Struktura me bërthamë betoni ose mure betoni: janë ato në të cilat forcat horizontale përballohen kryesisht nga këto bërthama ose mure. Struktura metalike i reziston vetëm ngarkesave gravitacionale




Figura 14 Struktura me mure betoni dhe konstruksion metalik

-Rama moment-rezistuese të kombinuara me kontraventime koncentrike: forcave horizontale u rezistojnë të dy sistemet, proporcionalisht shtangësisë së tyre.




Figura 15 Ramat e dyfishtë

-Rama moment-rezistuese të kombinuara me mbushje: forcat horizontale pranohen nga ky sistem hibrid, ku ramat moment-rezistuese dhe mbushjet nga betoni punojnë së bashku. Ky sistem projektohet sipas kapitullit 7 të EC8-1 (Rregullat për strukturat kompozite çelik-beton)




Figura 16 Rama moment-rezistuese e kombinuar me mbushje

Praktikisht, për optimizimin dhe projektimin e strukturave metalike në zonat sizmike adaptohen qasje të ndryshme. Së fundi si më praktike për të siguruar zonat disipuese që përfshihen në

projektim pavarësisht rrjedhjes të ndryshme të çelikut, autorët kanë zhvilluar konceptin e dyfishtë për ndërtesat në zona sizmike.

4.3 Faktori i sjelljes

Qasja e përgjithshme e projektimit e rekomanduar nga EC8 synon që të kontrollojë sjelljen joelastike të strukturës duke shmangur formimin e mekanizmit të katit të butë dhe thyerjen e brishtë. Në mënyrë që të arrihen këto synime, rregullat e projektimit bazohen në projektimin sipas kapacitetit të elementeve dhe detajimin në pjesët e zonave disipuese me rregulla specifike për të përmirësuar duktilitetin dhe kapacitetin e deformimit.

Për sistemet e strukturore të rregullta, këshillohet që faktori i sjelljes q të merret në kufijtë e sipërm të vlerave të referencës sipas tabelës së mëposhtme:

TIPI STRUKTUROR	Klasa e duktilitetit	
	DCM	DCH
a) Ramat moment-rezistuese	4	$5 \alpha_u / \alpha_1$
b) Ramat me kontraventime ekscentrike		
Me kontraventime diagonal	4	4
Me kontraventime V	2	2.5
c) Ramat me kontraventime ekscentrike	4	$5 \alpha_u / \alpha_1$
d) Lavjerrës i përmbysur	2	$2 \alpha_u / \alpha_1$
e) Struktura me bërthamë betoni ose mure betony	(shiko ramat nga betoni)	
f) Rama moment-rezistuese dhe me kontraventime koncentrike	4	$4 \alpha_u / \alpha_1$
g) Ramat moment-rezistuese me mbushje		
Mbushje betoni ose muraturë të palidhur, në kontakt me ramën	2	2
Mbushje betonarme të lidhura me ramën	(shiko ramat çelik-beton)	
Mbushje të izoluara nga ramat moment-rezistuese (shiko ramat moment-rezistuese)	4	$5 \alpha_u / \alpha_1$

Tabela 1 Kufiri i sipërm i vlerave referente të faktorëve të sjelljes

Faktori i sjelljes q , për sistemet me strukturë të rregullt është dhënë me shprehjen:

$$q = \frac{\alpha_u}{\alpha_1} q_0$$

q_0 - vlera referente e faktorit të sjelljes

α_u / α_1 - parametër për shpërndarjen plastike

α_u - vlera me të cilën shumëzohet veprimi sizmik horizontal projektues, në kushtet kur të gjitha veprimet e tjera projektuese janë konstante ashtu që të formohen çernierat plastike në një numër të mjaftueshëm seksionesh për shfaqjen e paqëndrueshmërisë strukturore.

α_1 - vlera me të cilën shumëzohet veprimi sizmik horizontal projektues me qëllim që të arrihet për herë të parë rezistenca në përkulje në njërin nga elementet e strukturës, ndërkohë që veprimet e tjera projektuese mbeten konstante.

-për ndërtesat që nuk janë të rregullta në plan, vlera e përafërt e α_u/α_1 e cila mund të përdoret kur nuk kryhet ndonjë llogaritje për vlerësimin e saj është ndërmjet vlerës 1.0 deri në 1.3.

-për vlerat e α_u/α_1 më të mëdha se 1.3, me kusht që ato të jenë të konfirmuara nga llogaritja e α_u/α_1 nëpërmjet analizës globale statike jolineare (“pushover”).

-vlera maksimale e α_u/α_1 që mund të përdoret në projektim është e barabartë me 1.6 edhe nëse analizat rezultojnë me vlera më të larta

5. Përshkrimi dhe projektimi i strukturës

Në shembullin e marrur për shqyrtim do të tregojmë hapat për projektimin e strukturës sipas EC8-1 për një objekt shumëkatësh të tipit strukturor “Rama moment-rezistuese” (Moment Resisting Frames–MRF).

5.1 Përshkrimi i objektit

Struktura është 10 kate e cila do të shfrytëzohet për afarizëm. Forma e saj është drejtkëndëshe me dimensione 31x24 m. Kati përdhese ka lartësi prej 4m, ndërsa katet tjera kanë lartësi prej 3.5m.

Pllaka e meskatit është kompozite nga llamarina e valëzuar. Pllaka ka për detyrë që të pranojë ngarkesat vertikale si dhe të sillet si diafragmë rigjide e aftë të përcjellë veprimet sizmike deri te ramat moment rezistues. Pllaka mbështet në profilet *I*. Në mënyrë që të shmanget bartja e ngarkesave nga pllaka në shtylla, konektorët e prerjes (shear connectors) aplikohen vetëm në trarë që kanë për detyrë të bartin ngarkesat gravitacionale.




Figura 17 Dukja e objektit

Ndërsa figura më poshtë tregon pozicionimin e ramave moment rezistuese (MRFs) në plan dhe në prerje, të cilat janë të theksuar me vijë më të trashë. Ramat moment rezistuese (MRFs) janë pozicionuar në disa vende, përderisa elementet sekondarë që janë projektuar që tu rezistojnë vetëm ngarkesave gravitacionale. Të gjithë elementet sekondarë kanë skemën statike çernierë-çernierë, përderisa elementet primar te ramave moment rezistuese janë të inkastruara plotësisht.




Figura 18 Elementet e strukturës në katin karakteristik




Figura 19 Prerja tërthore e ramave moment rezistues drejtimi X




Figura 20 Prerjia tërthore e ramave moment rezistues drejtimi Y

5.2 Materiali

Klasa	f_y (N/mm ²)	f_u (N/mm ²)	γ_M	γ_{ov}	E (N/mm ²)
S235	235	360	$\gamma_{M0}=1.0$	1.25	210000
			$\gamma_{M1}=1.0$		
			$\gamma_{M2}=1.25$		

Tabela 2 Klasa e çelikut

5.2.3 Karakteristikat e çelikut

Të dhënat materialit	Simboli	Vlera	Njësia	Referenca
Masa për njësi vëllimi	γ_s	$7.85 \cdot 10^{-9}$	kg/mm ³	EN1993-1-1, tabela A.4
Pesha për njësi vëllimi	γ_s	$7.7 \cdot 10^{-9}$	N/mm ³	EN1993-1-1, tabela A.4
Moduli i Elasticitetit	E_s	210000	N/mm ²	EN1993-1-1, 3.2.6(1)
Vlera e Poissonit	ν	0.3		EN1993-1-1, 3.2.6(1)
Koeficienti i bymimit termik (konstruksionet metalike)	α	$1.2 \cdot 10^{-5}$ per K (për $T \leq 100^\circ\text{C}$)	K	EN1993-1-1, 3.2.6(1)
Koeficienti i bymimit termik (konstruksionet kompozite beton-çelik)	α	$1.2 \cdot 10^{-5}$ per K (për $T \leq 100^\circ\text{C}$)	K	EN1993-1-1, 3.2.6(1)
Moduli i rrëshqitjes	G	≈ 81000	N/mm ²	EN1993-1-1, 3.2.6(1)
Kufiri i rrjedhshmërisë për profilet metalike	f_y	275	N/mm ²	EN1993-1-1, tabela 3.1
Rezistenca përfundimtare	f_u	430	N/mm ²	EN1993-1-1, tabela 3.1

Tabela 3 Vlerat karakteristike të çelikut

Klasa e çelikut	Trashësia nominale e elementit, t(mm)				
	t≤40mm		40mm<t≤80mm		Referenca
	f _y (N/mm ²)	f _u (N/mm ²)	f _y (N/mm ²)	f _u (N/mm ²)	EN 10025-2
S235	235	360	215	360	
S275	275	430	255	410	
S355	355	510	335	470	
S450	440	550	410	550	

Tabela 4 Vlerat nominale të sforcimit për prerjet e çelikut (EN1993-1-1, tabela 3.1)

5.3 Veprimet e ngarkesave

5.3.1 Vlerat karakteristike të ngarkesave

Nga EN 1991-1 për ngarkesë shfytëzuese kemi kategorinë B

G_k (kN/m ²)		Q_k (kN/m ²)
Pllaka e katit	4.2	2.0
Pllaka e kulmit	3.6	0.5
		1.0 (bora)
Shkallët	1.68	4.0
Fasada	2.0	-

Tabela 5 Vlerat e ngarkesave të përhershme dhe shfytëzuese në kate

5.3.2 Veprimet sizmike

$a_{gR}=0.25g$ është shpejtimi maksimal referencë i truallit,

trualli tipi C, marrim tipin 1

Nga analiza modale kemi spektrat e reagimit

5.3.2.1 Spektri i reagimit vertikal (EN1998-1-1, p3.2.2.3)

Komponenta vertikale e veprimit sizmik duhet të merret në llogari nëse $a_{vg}>0.25g$ ($2.5m/s^2$) në rastet si më poshtë:

- Për elementet strukturor horizontal me hapëisrë 20m' ose më shumë
- Për elementet konzollë më të gjata se 5m'
- Për komponentin strukturor horizontal ose afërsisht horizontal të parasforcuar
- Për trarët që mbajnë shtylla (kolona)
- Për strukturat e izoluara në bazë

